

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.

**Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

PERMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT MBI PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E E FITIM OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	4
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM	5
2. BAZAT E KONTABILITETIT	5
3. NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHËNIMET SHPJEGUESE	6
4. STANDARDE DHE INTERPRETIME TË REJA	7
5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL	9
6. VLERËSIMET DHE GJYKIMET NË ZBATIMIN E POLITIKAVE KONTABËL	20
7. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR	21
8. ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË SIGURIMIT	27
9. MENAXHIMI I RREZIKUT TË KAPITALIT	31
10. VLERA E DREJTË	32
11. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE	34
12. AKTIVE AFATGJATA JO-MATERIALE	35
13. AKTIVET E MBAJTURA PËR INVESTIM	35
14. AKTIVE MË TË DREJTË PËRDORIMI DHE DETYRIMET E QIRASË	36
15. AKSIONE NË SHOQËRI TË LIDHURA DHE DEGË	37
16. AKTIVE TË RISIGURIMIT	37
17. LETRA ME VLERË ME KOSTO TË AMORTIZUAR	37
18. DEPOZITA ME AFAT ME BANKAT	37
19. SHPENZIMET E SHTYRA TË MARRJËS NË SIGURIM	38
20. LLOGARI TE ARKËTUESHME NGA AKTIVITETI I SIGURIMIT DHE TË TJERA	38
21. AKTIVE TË TJERA	39
22. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO DHE MJETE MONETARE TË KUFIZUARA ..	40
23. KAPITALI AKSIONAR	40
24. REZERVA PËR RREZIQË TË TJERA	40
25. DETYRIME PËR KONTRATAT E SIGURIMIT	41
26. DETYRIME TATIMORE DHE TË TJERA	42
27. DEPOZITA E RISIGURUESIT	42
28. DETYRIME NGA AKTIVITETI I SIGURIMIT DHE TË TJERA	42
29. PRIMET E SHKRUARA BRUTO	42
30. REZERVA PËR PRIMET E PAFITUARA	43
31. PRIME TË ÇEDUARA TË RISIGURUESIT	43
32. KOMISIONE TË RISIGURIMIT	43
33. TË ARDHURA NGA INVESTIMET	43
34. SHPENZIME TË MARRJES NË SIGURIM	43
35. SHPENZIME ADMINISTRATIVE	44
36. SHPENZIME TË TJERA SIGURIMI	44
37. FITIMI NGA KURSET E KËMBIMIT, NETO	44
38. KOSTOT FINANCIARE	44
39. TATIM FITIMI	45
40. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA	46
41. PALËT E LIDHURA	46
42. NGJARJE PAS DATES SË RAPORTIMIT.	48

Sigma Interbalkanian Vienna Insurance Group SH.A.

Pasqyra e pozicionit financiar

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVET			
Aktive afatgjata materiale	11	307,754	311,654
Aktive afatgjata jo-materiale	12	53,157	57,434
Aktive të mbajtura për investime	13	281,828	68,500
Aktive me te drejte perdorimi	14	51,025	311,113
Aksione në shoqëri të lidhura	15	20,543	20,543
Aktive të risigurimit	16	2,555,850	2,671,737
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	17	3,312,062	2,856,970
Tatimi mbi fitimin i arkëtueshëm		4,544	1,809
Depozita me afat me bankat	18	1,999,242	2,036,769
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	19	379,532	349,018
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	20	256,514	207,456
Aktive të tjera	21	145,240	131,114
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to dhe mjete monetare të kufizuara	22	315,406	305,494
TOTALI I AKTIVEVE		9,682,697	9,329,611
KAPITALI			
Kapitali aksionar	23	498,213	498,213
Rezerva e rrezikut të sigurimit dhe ligjore	24	594,192	594,192
Rezerva e rivlerësimit	24	56,727	60,706
Rezerva e bashkimit	24	333,207	333,207
Rezerva e përkthimit		(45,400)	(26,544)
Fitime të pashpërndara		558,019	390,379
TOTALI I KAPITALIT		1,994,958	1,850,153
DETYRIMET			
Detyrime për kontratat e sigurimit	25	3,988,344	3,945,765
Rezerva për primet e pafituara	30	1,732,959	1,635,449
Detyrime tatimore të shtyra	39	5,802	6,503
Detyrime tatimore dhe të tjera të ngjashme	26	31,252	32,245
Detyrim për qira afatgjate	14	291,481	318,570
Depozita e risiguresit	27	1,276,963	1,244,524
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	28	360,938	296,402
TOTALI I DETYRIMEVE		7,687,739	7,479,458
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		9,682,697	9,329,611

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga bordi drejtues i Shoqërisë më datë 19.05.2022, dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Klaudi Çitozi
Drejtor i Përgjithshëm



Ilir Elmazi
Drejtor Ekzekutiv i VIG Services

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.

Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukseve të parasë për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë audituar nga një tjetër auditues i cili ka lëshuar një opinion të pamodifikuar më 1 qershor 2021.

Informacione të Tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2021 të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Shoqërisë për vitin 2021, përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë për vitin 2021 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomali të materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

9 qershor 2022
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Auditues Ligjor

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.**Pasqyra e e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Prime të shkruara bruto	29	3,773,098	3,510,487
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara bruto	30	(111,163)	(39,378)
<i>Te ardhura nga primet e sigurimit</i>		3,661,935	3,471,109
Prime të çeduar të risiguruesit	31	(1,721,489)	(1,594,457)
Ndryshimi në rezervën e risiguruesit për primet e pafituara	30	63,180	(11,697)
<i>Të ardhura të primit të sigurimit të çeduar te risiguruesi</i>		(1,658,309)	(1,606,154)
Të ardhura neto nga primet e sigurimit		2,003,626	1,864,955
Të ardhura nga komisionet e risigurimit	32	710,501	654,120
Të ardhura nga investimet	33	161,834	156,798
Të ardhura të tjera		10,355	3,670
Të ardhura neto		2,886,316	2,679,543
Dëme të paguara bruto	25	(1,855,469)	(1,610,571)
Dëme të paguara nga risiguruesi	25	879,294	697,910
Ndryshimi në rezervën e dëmeve bruto	25	(72,287)	(468,666)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risiguruesit	25	(165,692)	272,124
Dëmet neto të sigurimit dhe përfitime		(1,214,154)	(1,109,203)
Shpenzimet të marrjes në sigurim	34	(729,670)	(688,300)
Shpenzime administrative	35	(608,630)	(572,858)
Shpenzime të tjera sigurimi	36	(42,883)	(39,500)
Shpenzime		(1,381,383)	(1,300,658)
Të ardhura nga kurset e këmbimit, neto	37	3,538	(12,734)
Shpenzime financiare	38	(21,767)	(21,196)
Fitim/(humbje) para tatimit		272,750	235,752
Tatimi mbi fitimin	39	(41,288)	(43,402)
Fitim/(humbje) e vitit		231,462	192,350
Zërat që nuk do të riklasifikohen në fitim ose humbje:			
<i>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse, neto nga taksat</i>		(18,856)	(18,895)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		212,606	173,455

Shenimet shoqeruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e ketyre pasqyrave financiare.

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.**Pasqyra e ndryshimeve në kapital***(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Kapitali aksionar	Rezerva e sigurimit	Rezerva e bashkimit	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e përkthimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2020	498,213	171,792	333,207	64,683	(7,649)	616,452	1,676,698
Riklasifikimi i rezervës së kapitalit së Degës së Kosovës	-	422,400	-	-	-	(422,400)	-
Gjendja më 1 janar 2020 (e riklasifikuar)	498,213	594,192	333,207	64,683	(7,649)	194,052	1,676,698
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	192,350	192,350
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksa	-	-	-	-	(18,895)	-	(18,895)
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	(18,895)	192,350	173,455
Transferimi i amortizimit për ndërtesat	-	-	-	(3,977)	-	3,977	-
Shpërndarja e dividendit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	498,213	594,192	333,207	60,706	(26,544)	390,379	1,850,153
Gjendja më 1 janar 2021	498,213	594,192	333,207	60,706	(26,544)	390,379	1,850,153
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	231,462	231,462
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksa	-	-	-	-	(18,856)	-	(18,856)
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	(18,856)	231,462	212,606
Transferimi i amortizimit për ndërtesat	-	-	-	(3,979)	-	3,979	-
Shpërndarja e dividendit	-	-	-	-	-	(67,801)	(67,801)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	498,213	594,192	333,207	56,727	(45,400)	558,019	1,994,958

Shenimet shoqeruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e ketyre pasqyrave financiare.

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.

Pasqyra e flukseve monetare

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi para tatimit		272,750	235,752
Fluksi i parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit			
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi	11,12	107,321	73,432
Ndryshime në vlerën e drejtë të aktiveve të mbajtuara për investime	13		4,350
Zhvlerësimi për sigurimet e arkëtueshme	20	4,242	6,209
Shpenzime interesi	38	21,767	21,194
Të ardhura nga investimet	33	(160,363)	(156,798)
Fluksi i parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit para ndryshimeve në aktivet dhe detyrime		245,717	184,139
Ndryshime në të arkëtueshmet nga sigurimi e të tjera		(56,733)	75,258
Ndryshime në aktivet e tjera		(6,530)	2,654
Ndryshime në aktive të risigurimit		99,669	(234,315)
Ndryshime në kostot e shtyra të marrjes së sigurimit		(31,881)	4,011
Ndryshime në detyrime për kontratat e sigurimit		72,287	486,246
Ndryshime në rezervën për primet e pafituara		111,164	47,212
Ndryshime në depozitat e risigurimit		41,154	56,584
Ndryshime në detyrime të tjera		(8,148)	(25,242)
Ndryshime në të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		67,174	50,923
Ndryshime në mjete monetare të kufizuara		6,312	10,813
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet e shfrytëzimit përpara interesave dhe taksës		540,185	658,283
Interesi i arkëtuar		143,386	126,914
Interesi i paguar		(16,964)	(14,749)
Tatim fitimi i paguar		(46,443)	(47,015)
Flukset monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		620,164	723,433
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale e jo-materiale	11,12	(26,835)	(26,454)
Blerje e letrave me vlerë me kosto të amortizuara		(450,712)	(637,811)
Rënie në depozitat me afat		2,242	(5,116)
Rritje në aksione në shoqëri të lidhura		-	(5,889)
Flukset monetare neto të përdorura nga aktivitetet investuese		(475,305)	(675,270)
Flukset monetare nga aktivitetet finacuese			
Qira të paguara		(62,051)	(58,820)
Dividend i paguar		(64,187)	-
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet finacuese		(126,238)	(58,820)
Ulje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		18,621	(10,657)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to dhe mjete monetare të kufizuara në fillim të vitit		294,681	312,762
Efekt i kursit të këmbimit në mjetet monetare		(2,397)	(7,424)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to dhe mjete monetare të kufizuara në fund të vitit	22	310,905	294,681

Shenimet shoqeruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e ketyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Këto pasqyra financiare janë përgatitur nga Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A. ("Shoqëria" ose "SIVIG") si pasqyra financiare ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar ("SNRF").

"SigmaInterAlbanian VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a ("Shoqëria" ose "SIVIG" e njohur më parë si Sigma VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a ose SIGMA) është themeluar në 1999 dhe regjistruar në Gjykatën e Tiranës me Vendimin Nr.20487 me datë 3 shkurt 1999. Më 30 shtator 2014, emri i Shoqërisë ndryshoi në Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A. pas bashkimit me përthithje të InterAlbanian SH.A., degë e Vienna Insurance Group.

Shoqëria mëmë e Shoqërisë është Vienna Insurance Group Ag Wiener Versicherung Gruppe, Vjenë, Austri, e cila zotëron 89.05% të aksioneve. Pala kontrolluese përfundimtare e Grupit është Wiener Städtische Wechselseitiger Versicherungsverein - Vermögensverëaltung - Vienna Insurance Group, Vjenë, Austri.

Aktiviteti kryesor: Aktiviteti kryesor i Shoqërisë përfshin sigurimin e ekspozimeve për mjetet motorike, pasuritë, shëndetin dhe produkte të tjera të ndryshme të sigurimit të jo – jetës në Shqipëri dhe Kosovë. Operacionet në Kosovë menaxhohen prej degës së shoqërisë

Aktiviteti i Shoqërisë në Shqipëri është subjekt i ligjit nr. 9901 datë 14 prill 2008 "Mbi sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimi" ("akti i sigurimit"). Rregullatori i tregut të sigurimeve në Shqipëri është Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (në vijim "Autoriteti" ose "AMF").

Dega është themeluar më 11 tetor 2004 dhe operon me licencë të lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për të siguruar sigurimin e përgjithshëm të rrezikut të jojetës në Republikën e Kosovës sipas dispozitave të Ligjit të Sigurimeve të Kosovës, Ligji nr. 05/L045 "Për Sigurimet". Dega gjithashtu duhet të depozitojë një shumë minimale prej 3,200 mijë euro në formën e kapitalit themeltar në mënyrë që të mund të siguroj rreziqet e sigurimit për të cilat është e licencuar në Republikën e Kosovës.

Adresa e zyrtare e regjistruar: Zyrtat qendrore të Shoqërisë gjenden në Rr. Komuna e Parisit, Pallatet Lura, Kati i dytë, Tiranë, Shqipëri. Adresa e degës është në Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Shoqëria kishte 317 punonjës më 31 dhjetor 2021 (2020: 305).

Bordi mbikqyrës dhe bordi drejtues gjatë vitit 2021 dhe deri në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare konsiston si më poshtë:

Bordi Mbikëqyrës	Pozicioni	Bordi Drejtues	Pozicioni
Z. Peter Hoefinger	Kryetar	Z. Klaidi Citozi	Drejtor i Përgjithshëm
Z. Christoph Rath	Zv. Kryetar	Z. Artan Pjeternikaj	Anëtar Bordi
Z. Jonard Prodani	Anëtar	Z. Ervin Rali	Anëtar Bordi
Zj. Liane Hirner	Anëtar		
Zj. Sonja Raus	Anëtar		

2. Bazat e kontabilitetit

Këto pasqyra financiare të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. (referencuar më poshtë si "Shoqëria") janë përgatitur në përputhje me SNRF-të) siç është lëshuar nga Bordi i Standardeve Nderkombetare të Kontabilitetit (BSNK).

Monedha funksionale dhe e paraqitjes Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë Shqiptare (Lekë), të rrumbullakosura në mijë Lekë. Lekë është monedha funksionale e njësisë raportuese, monedha kryesore e mejdiseit ekonomik në të cilin njësia raportuese kryen veprimtarinë e saj. Monedha funksionale e operacioneve të saj të jashtme në Kosovë është Euro ("EUR") siç përkthuhet në shënimin 5.b..

Bazat e matjes. Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të pronave të investuara dhe ndërtesave të caktuara (të klasifikuara si prona dhe pajisje) të cilat maten me vlerën e drejtë.

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe (shiko shënimin 3 për miratimin e standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara dhe deklaratave të reja kontabël të miratuara nga Shoqëria).

2. Bazat e matjes (vazhdim)

Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kontabël. Gjithashtu kërkohet që drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë të ardhshme që preket. Drejtimi beson se supozimet bazë janë të përshtatshme dhe se pasqyrat financiare si rrjedhojë paraqesin pozicionin financiar dhe rezultatet në mënyrë të drejtë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë të detajuara në shënimin 6.

Vijimësia. Drejtimi i Njesisë Raportuese ka vlerësuar aftësinë për të vazhduar në vijimësi dhe është i kënaqur që ka burime për të vazhduar biznesin për të ardhmen e parashikueshme. Njësia Raportuese është e kapitalizuar mirë dhe ka marzhe të mira sigurie nga raportet minimale rregullatore. Drejtimi nuk është i vetëdijshëm për ndonjë pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Njesisë Raportuese për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten mbi bazën e vazhdimësisë.

Krahasueshmëria. Riklasifikime të caktuara janë bërë me qëllim që të sigurohet një prezantim dhe shpalosje më e mirë në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020. Më konkretisht:

- "Kapitali i themeluar i Degës në Kosovë" prej 422,400 mijë lekë është paraqitur nën "Fitimet e pashpërndara" në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, dhe për të dyja periudhat që përfundojnë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 kjo është paraqitur në "Rezervat ligjore të sigurimeve". Në lidhje me këtë riklasifikim janë bërë shpalosjet përkatëse në shënimet e pasqyrave financiare.
- "Mjete monetare të kufizuara" prej 481 mijë lekësh është paraqitur si mjete monetare dhe ekuivalente monetare në pasqyrën e flukseve monetare dhe për të dyja periudhat që përfundojnë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 kjo është paraqitur si aktivitet operativ. Në lidhje me këtë riklasifikim janë bërë shpalosjet përkatëse në shënimet e pasqyrave financiare.
- "Interesi i marrë" prej 126,914 mijë lekë është paraqitur në aktivitetin investues në pasqyrën e flukseve monetare dhe për të dyja periudhat që përfundojnë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, kjo është paraqitur si aktivitet operativ.

3. Ndryshime në politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese

Politikat kontabël të miratuara janë në përputhje me ato të vitit financiar të mëparshëm, me përjashtim të SNRF-ve të mëposhtme të ndryshuara në vijim, të cilat janë miratuar nga Shoqëria më 1 janar 2021:

- **Reforma e Referencës së Normës së Interesit – Faza 2 – SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 (Ndryshime)**

Në gusht 2020, BSNK publikoi Reformën e Referencës së Normës së Interesit – Faza 2, Amendimet e SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16, duke përfunduar punën e saj në përgjigje të reformës IBOR. Amendimet parashikojnë lehtësime të përkohshme të cilat trajtojnë efektet e raportimit financiar kur norma e interesit ndërbankar (IBOR) që ofrohet zëvendësohet me një normë interesi alternative pothuajse pa rrezik (RFR). Në veçanti, amendimet parashikojnë një lehtësi praktike për kontabilizimin e ndryshimeve në bazën e përcaktimit të flukseve monetare kontraktuale të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare, për të kërkuar që norma efektive e interesit të rregullohet, e cila është ekuivalente me një lëvizje në një normë interesi të tregut. Gjithashtu, amendimet prezantojnë lehtësime nga ndërprerja e marrëdhënieve mbrojtëse, duke përfshirë një lehtësim të përkohshëm nga detyrimi për të përmbushur kërkesat që janë identifikuar veçmas në momentin kur një instrument RFR përcaktohet si një mjet mbrojtës për një element të rrezikut. Amendime janë bërë edhe tek SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese me qëllim për t'u ofruar përdoruesve të pasqyrave financiare mundësinë për të kuptuar efektin e reformës së referencës së normës së interesit në instrumentet financiare të një njësie ekonomike subjekti si dhe strategjinë e administrimit të riskut. Për shkak se zbatimi i standardit është retrospektiv, subjektet nuk janë të detyruara që të riparaqesin periudhat e mëparshme. Ndryshimet nuk kishin ndikim në pasqyrat financiare sepse Njësia Raportuese nuk ka investime me normë fleksibël që parashikohet të ndryshojë normën.

3. Ndryshime në politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese (vazhdim)

- **SNRF 4: Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet)**

Ndryshimet në SNRF 4 ndryshojnë datën fikse të skadencës për përjashtimin e përkohshëm në SNRF 4 Kontratat e Sigurimit nga zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare, në mënyrë që njësitë ekonomike do t'u kërkohej të zbatojnë SNRF 9 për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023. Njësia Raportuese ka një projekt në vazhdim dhe po vlerëson ndikimin.

4. Standarde dhe interpretime të reja

Janë publikuar disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021 ose më vonë, dhe të cilat Shoqëria nuk i ka adoptuar herët.

- **SNRF 17: Kontratat e Sigurimit**

Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2021 me aplikim më të hershëm të lejuar nëse janë zbatuar edhe SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët dhe SNRF 9 Instrumentet Financiare. Në mbledhjen e tij të marsit 2020, Bordi vendosi të shtyjë datën e hyrjes në fuqi në vitin 2023. SNRF 17 Kontratat e Sigurimit përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të kontratave të sigurimit të lëshuara. Ai gjithashtu kërkon që parime të ngjashme të zbatohen për kontratat e risigurimit të mbajtura dhe kontratat e investimit me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionale të lëshuara. Objektivi është të sigurohet që njësitë ekonomike të ofrojnë informacionin përkatës në një mënyrë që përfaqëson me besnikëri ato kontrata. Ky informacion u jep një bazë përdoruesve të pasqyrave financiare për të vlerësuar efektin që kanë kontratat brenda objektit të SNRF 17 në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të një njësie ekonomike. Projekti SNRF 17 po organizohet dhe zbatohet në nivel grupi. Njësia Raportuese po rivlerëson modelet e saj në mënyrë që të jetë gati dhe në përputhje me kërkesat e reja. Një studim paraprak i kërkesave teknike dhe thelbësore të SNRF 17 u krye përpara fillimit të projektit SNRF 17 në të gjithë Shoqërinë Raportuese. Pas analizimit të rezultateve të studimit paraprak, u krijua një strukturë projekti në të gjithë Shoqërinë Raportuese. Standardi SNRF 17 është trajtuar në mënyrë specifike në një sërë grupesh pune metodologjike që nga fillimi i programit. Projekti i Shoqërisë Raportuese po fokusohet gjithashtu në rishikimin e modelit aktuarial dhe zbatimin e një nënlibri llogarish për nënshkrimet. Për shkak të pasigurive ekzistuese, aktualisht nuk është e mundur të përcaktohet sasia e efektit në pasqyrat individuale të pozicionit financiar dhe zërat e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Megjithatë, Shoqëria Raportuese pret që standardi i ri do të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat e saj financiare.

- **SNRF 17: Kontratat e sigurimit – Zbatimi fillestar i SNRF 17 dhe SNRF 9 – Informacion Krahases (Ndryshime)**

Ndryshimi është efektiv për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në ose pas 1 janarit 2023, me zbatimin e hershëm të lejuar përkatësisht me SNRF 17. Për njësitë ekonomike që zbatojnë fillimisht SNRF 17 dhe SNRF 9 në të njëjtën kohë, ndryshimi shton një opsion kalimi për një "mbivendosje klasifikimi", në lidhje me informacionin krahasues të aktiveve financiare. Një njësi ekonomike që aplikon mbivendosjen e klasifikimit për një aktiv financiar duhet të paraqesë informacion krahasues sikur kërkesat e klasifikimit dhe matjes të SNRF 9 të ishin zbatuar për atë aktiv financiar. Gjithashtu, në zbatimin e mbivendosjes së klasifikimit për një aktiv financiar, një njësi ekonomike nuk i kërkohej të zbatojë kërkesat e zhvlerësimit të SNRF 9. Ndryshimi synon të ndihmojë njësitë ekonomike të shmangin mospërputhjet e përkohshme kontabël midis aktiveve financiare dhe detyrimeve të kontratës së sigurimit, dhe për rrjedhojë të përmirësojnë dobinë e informacionit krahasues për përdoruesit e pasqyrave financiare. Këto ndryshime nuk janë miratuar ende nga BE. Drejtimi ka një projekt në vazhdim dhe pret ndikim të rëndësishëm në pasqyrat e tij financiare.

4. Standarde dhe interpretime të reja (vazhdim)

- **Ndryshim në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta: Shitja ose Kontributi i Aktiveve ndërmjet një Investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët**

Ndryshimet trajtojnë një mospërputhje të pranuar midis kërkesave në SNRF 10 dhe atyre në SNK 28, në trajtimin e shitjes ose kontributit të aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët. Pasoja kryesore e ndryshimeve është se një fitim ose humbje e plotë njihet kur një transaksion përfshin një biznes (nëse ai është i vendosur në një filial ose jo). Një fitim ose humbje e pjesshme njihet kur një transaksion përfshin aktive që nuk përbëjnë një biznes, edhe nëse këto aktive janë të vendosura në një filial. Në dhjetor 2015, BSNK shtyu datën e hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi për një kohë të pacaktuar në pritje të rezultatit të projektit të saj kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të kontabilitetit. Njësia Raportuese ka vlerësuar se ndryshimi nuk do të ketë ndikim në Pasqyrat e saj Financiare.

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Detyrimeve si Aktuale ose Jorjedhëse (Ndryshime)**

Ndryshimet fillimisht ishin efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me aplikimin e mëhershëm të lejuar. Megjithatë, në përgjigje të pandemisë Covid-19, Bordi e ka shtyrë datën e hyrjes në fuqi me një vit, pra 1 janar 2023, për t'u dhënë Shoqërive më shumë kohë për të zbatuar çdo ndryshim klasifikimi që rezulton nga ndryshimet. Ndryshimet synojnë të nxisin konsistencën në zbatimin e kërkesave duke ndihmuar Shoqëritë të përcaktojnë nëse, në pasqyrën e pozicionit financiar, borxhi dhe detyrimet e tjera me një datë të pasigurt shlyerjeje duhet të klasifikohen si rrjedhëse ose afatgjata. Ndryshimet ndikojnë në paraqitjen e detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar dhe nuk ndryshojnë kërkesat ekzistuese rreth matjes ose kohës së njohjes së ndonjë aktivi, pasivi, të ardhurash ose shpenzimi, as informacionin që njësitë japin informacione për këta zëra. Gjithashtu, ndryshimet sqarojnë kërkesat e klasifikimit për borxhin që mund të shlyhet nga shoqëria që emeton instrumente të kapitalit të vet.

Në nëntor 2021, Bordi lëshoi një draft ekspozimi (DE), i cili sqaron se si të trajtohen detyrimet që janë subjekt i marrëveshjeve për t'u zbatuar, në një datë pas periudhës raportuese. Në veçanti, Bordi propozon ndryshime me shtrirje të ngushtë në SNK 1, të cilat në mënyrë efektive i kthejnë ndryshimet e vitit 2020, duke kërkuar që njësitë ekonomike të klasifikojnë si rrjedhëse, detyrimet që i nënshtrohen marrëveshjeve, të cilat duhet të përmbushen vetëm brenda dymbëdhjetë muajve të ardhshëm pas periudhës së raportimit, nëse ato marrëveshje nuk janë u takua në fund të periudhës raportuese. Në vend të kësaj, propozimet do të kërkonin që njësitë ekonomike të paraqesin veçmas të gjitha detyrimet afatgjata që i nënshtrohen marrëveshjeve për t'u përmbushur vetëm brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit. Për më tepër, nëse njësitë ekonomike nuk respektojnë këto marrëveshje të ardhshme në fund të periudhës raportuese, do të kërkohej dhënie informacionesh shpjeguese shtesë. Propozimet do të hyjnë në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024 dhe do të duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8, ndërkohë që lejohet miratimi i hershëm. Bordi ka propozuar gjithashtu që të shtyhet data e hyrjes në fuqi e ndryshimeve të vitit 2020 në përputhje me rrethanat, në mënyrë që subjekteve të mos u kërkohej të ndryshojnë praktikën aktuale përpara se ndryshimet e propozuara të hyjnë në fuqi. Shoqëria Raportuese ka vlerësuar se ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivet afatgjata materiale, objektet dhe pajisjet; SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet Kontingjente si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 (Ndryshimet)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022 me aplikim të mëhershëm të lejuar. BSNK ka nxjerrë ndryshime me qëllim të ngushtë në Standardet SNRF si më poshtë:

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Ndryshimet)** përditësojnë një referencë në SNRF 3 për Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar pa ndryshuar kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit.
- **SNK 16 Aktivet afatgjata materiale (Ndryshimet)** e ndalon një Shoqëri të zbresë nga kostoja e aktiveve afatgjata materiale shumat e marra nga shitja e artikujve të prodhuar ndërkohë që Shoqëria po përgatit aktivin për përdorimin e synuar. Në vend të kësaj, një Shoqëri do të njohë të ardhurat e tilla nga shitjet dhe kostot përkatëse në fitim ose humbje.
- **SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara (Ndryshimet)** specifikojnë se cilat kosto përfshin një shoqëri në përcaktimin e kostos së përmbushjes së një kontrate me qëllim të vlerësimit nëse një kontratë është rënduese.

4. Standarde dhe interpretime të reja (vazhdim)

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivët afatgjatë materiale, objektet dhe pajisjet; SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivët Kontingjente si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 (Ndryshimet) (vazhdim)**

- **Përmirësimet vjetore 2018-2020** bëjnë ndryshime të vogla në SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNK 41 Bujqësia dhe shembujt ilustrues që shoqërojnë SNRF 16 Qiratë

Njësia Raportuese ka vlerësuar se ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

- **SNRF 16 Qiratë-Covid 19 Koncesionet e Qirasë të Lidhura (Ndryshim)** - Ndryshimi zbatohet për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 Prill 2021, me aplikim të mëhershëm të lejuar, duke përfshirë në pasqyrat financiare të paautorizuara ende për publikim në datën e lëshimit të amendamentit. Në mars 2021, Bordi ndryshoi kushtet e dobisë praktike në SNRF 16 që ofron lehtësim për qiramarrësit nga zbatimi i udhëzimit të SNRF 16 mbi modifikimet e qirasë për koncesionet e qirasë që lindin si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë Covid-19. Pas ndryshimit, dobia praktike tani zbatohet për koncesionet e qirasë për të cilat çdo reduktim në pagesat e qirasë prek vetëm pagesat që duhet të paguheshin fillimisht në ose para datës 30 qershor 2022, me kusht që të plotësohen kushtet e tjera për aplikimin e dobisë praktike.

Ndryshimi nuk kishte ndikim në pasqyrat financiare të Njesisë Raportuese pasi ajo nuk kishte ndonjë ndryshim të afatit të qirasë lidhur me Covid-in.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme nga Njësia Raportuese, përveç nëse është shprehur ndryshe.

(a) Investimet e përbashkëta dhe kontabilizimi për degët e njësisë raportuese në vendet e tjera.

Investimet në filiale, pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta maten me kosto minus humbjen nga zhvlerësimi. Kostot e transaksionit kapitalizohen si pjesë e kostonë së investimit. Kostot e transaksionit janë kostot që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes së investimit, një tarifë e tillë e profesionit për shërbimet ligjore, taksat e transferimit dhe kostot e tjera të blerjes. Kostoja fillestare e investimeve përfshin gjithashtu edhe shumën e kushtëzuar. Rivlerësimi i mëposhtëm i shumës së kushtëzuar të klasifikuar si pasiv financiar rregullohet kundrejt kostove të investimit. Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues se vlera kontabël e një investimi mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse shumën e rikuperueshme të një investimi (vlera më e lartë e vlerës së drejtë minus kostonë e shitjes dhe vlera e tij në përdorim) është më e vogël se vlera kontabël e saj, atëherë vlera kontabël zvogëlohet në shumën e rikuperueshme. Vlera kontabël e një investimi çregjistrohet nga nxjerrja jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit të shitjes dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël neto të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga shitja. E njëjta vlen edhe nëse rezultati i nxjerrë jashtë përdorimit rezulton në një hap më poshtë nga filiali tek sipërmarrja e përbashkët ose një pjesëmarrje, matet me kosto.

Marrëveshje të përbashkëta. Sipas SNRF 11, investimet në marrëveshjet e përbashkëta klasifikohen si operacione të përbashkëta ose sipërmarrje të përbashkëta, në varësi të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të secilit investitor. Njësia raportuese ka vlerësuar natyrën e marrëveshjes së saj të përbashkët me Intersig Vienna Insurance Group SH.A. në VIG Services sh.p.k. dhe i përcaktoi ato si sipërmarrje të përbashkëta. Sipërmarrjet e përbashkëta maten me kosto minus humbjen nga zhvlerësimi. Shoqëria ka përdorur përjashtimin sipas SNK 28.

Shitja e filialeve, pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta. Kur njësia raportuese pushon të ketë kontroll ose ndikim të rëndësishëm, çdo interes i ruajtur në njësinë ekonomike rimerret në vlerën e tij të drejtë në datën kur humbet kontrolli, me ndryshimin në vlerën kontabël neto të njohur në fitim ose humbje. Vlera e drejtë është vlera kontabël fillestare për qëllime të kontabilizimit të mëvonshëm të interesit të mbajtur si një pjesëmarrje, sipërmarrje e përbashkët ose aktiv financiar. Përveç kësaj, çdo shumë e njohur më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në lidhje me atë njësi ekonomike, llogaritet sikur njësia raportuese të kishte drejtpërdrejt në dispozicion aktivet ose detyrimet përkatëse. Kjo mund të thotë që shumën e njohura më parë në të ardhura të tjera përmbledhëse janë riklasifikuar në fitim ose humbje. Nëse interesi i pronësisë në një pjesëmarrje zvogëlohet, por ndiqet një ndikim i rëndësishëm, vetëm një pjesë proporcionale e shumave të njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse riklasifikohen në fitim ose humbje kur është e përshtatshme.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Filialet që veprojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Njësia raportuese vepron në Kosovë përmes filialeve të saj, të cilat janë regjistruar në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës. Njësia raportuese raporton aktivitetet e filialeve të saj të huaj në pasqyrat financiare të konsoliduara si pjesë përbërëse e subjektit raportues duke grupuar të gjitha bilancet dhe transaksionet e saj sikur të ishte një njësi e vetme ekonomike.

(b) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë njohur me kosto historike konvertohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Rezultatet dhe pozicioni financiar i operacioneve të huaja përkthehen në monedhën e prezantimit të këtyre pasqyrave financiare si më poshtë:

- i. aktivitetet dhe detyrimet për çdo pasqyrë të pozicionit financiar janë përkthyer me normën e mbylljes në fund të periudhës përkatëse raportuese;
- ii. të ardhurat dhe shpenzimet përkthehen me kursin mesatar të këmbimit (përveç rastit kur kjo mesatare nuk është një përafrim i arsyeshëm i efektit kumulativ të normave që mbizotërojnë në datat e transaksionit, në të cilin rast të ardhurat dhe shpenzimet përkthehen në datat e transaksioneve);
- iii. të gjitha diferencat e këmbimit që rezultojnë njihen në të ardhura të tjera përmbledhëse dhe akumulohen në rezervën e përkthimit në kapital dhe;
- iv. Rezerva e kapitalit të autorizuar të Degës së Kosovës përkthehet me kurs historik.
- v. flukset monetare përkthehen gjithashtu në monedhën e prezantimit duke përdorur kursin mesatar të këmbimit për periudhën.

(c) Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Produktet e sigurimit të njësisë raportuese klasifikohen në momentin e krijimit, për arsye kontabël, si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi mbetet e tillë derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhen ose pushojnë së ekzistuari.

Kontratat nën të cilat njësia raportuese pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja sigurore) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar.

Ndërkohë që Bordi Drejtues konsideron që detyrimet e sigurimit për dëmet dhe rikuperimet e risigurimeve përkatëse, përfshirë rezervat dhe rezervat e paparashikuara për një proces ligjor, janë deklaruar në mënyrë të drejtë, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rezultat i informacionit dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në rregullime të konsiderueshme të shumat e parashikuara. Rregullimet në shumat e detyrimeve të sigurimit pasqyrohen në pasqyrat financiare për periudhën në të cilën bëhen rregullimet.

Administrimi i rrezikut të sigurimit diskutohet në detaje në Shënimin 9, ndërsa provizionet e kontratës së sigurimit janë analizuar në Shënimin 25. Kushtëzimet lidhur me dëmet e cështjeve ligjore janë shpalosur në Shënimin 41.

Përcaktimi i afatit të qirasë. Njësia Raportuese merr me qira ndërtesat e zyrave nga palët e treta në bazë të kontratave që kanë data të përcaktuara përfundimi dhe rinovohen automatikisht, përveç rasteve kur njëra palë paraqet një njoftim përfundimi prej 1 muaji. Njësia Raportuese përcakton periudhën e qirasë jo të mundshme për qiratë e tilla, duke marrë parasysh gjomat që do të ndodhin pas përfundimit, duke përfshirë dekurajime ekonomike siç janë përmirësimet e qirasë, kostoja e zhvendosjes ose rëndësia e lokaleve për operimet e Njësisë Raportuese. Si rezultat, afati i qirasë për ndërtesat më të rëndësishme të zyrave është përcaktuar si një periudhë 10 vjet duke përfshirë opsionin e zgjatjes.

Në përcaktimin e afatit të qirasë, drejtimi merr në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat që krijojnë një mundësi ushtruar një opsion zgjatjeje. Kjo përdoret për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në drejtim të administrimit të aktivitetit të përdorur në operacionet e Njësisë Raportuese. Shumica e opsioneve të zgjatjes dhe përfundimit të mbajtura janë të ushtrueshme nga Njësia Raportuese dhe jo nga qiradhënësi përkatës. Në përcaktimin e afatit të qirasë, drejtimi merr në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat që krijojnë një stimulim ekonomik për të ushtruar një opsion zgjatjeje, ose të mos ushtrojnë një opsion përfundimi. Opsionet e zgjatjes (ose periudhat pas opsioneve të përfundimit) përfshihen në afatin e qirasë vetëm nëse qiraja është e sigurt se do të zgjatet (ose nuk përfundon). Për qiradhëniet e ndërtesave, faktorët e mëposhtëm janë zakonisht më të rëndësishmit:

- Nëse ka penalitete të konsiderueshme për të përfunduar kontratën (ose jo për të zgjatur), Njësia Raportuese është zakonisht e sigurt që do të zgjasë kontratën (ose jo të përfundojë).
- Nëse ndonjë përmirësim i qirasë pritet të ketë një vlerë të konsiderueshme të mbetur, Njësia Raportuese është zakonisht e sigurt që do të zgjasë kontratën (ose jo të përfundojë).
- Përndryshe, Njësia Raportuese merr në konsideratë faktorë të tjerë, përfshirë historikun e kohëzgjatjes të qirasë, kostot që kërkohet për të zëvendësuar aktivin e marrë me qira dhe rëndësinë e vendndodhjes.

Shumica e opsioneve të zgjatjes në qiratë e automjeteve nuk janë përfshirë në detyrimin e qirasë, sepse Njësia Raportuese mund të zëvendësojë aktivet pa kosto të rëndësishme. Afati i qirasë rivlerësohet nëse një opsion është ushtruar (ose nuk ushtrohet) ose Njësia Raportuese detyrohet ta ushtrojë (ose jo ta ushtrojë) atë. Vlerësimi i një sigurie të arsyeshme rishikohet vetëm nëse ndodh një ngjarje e rëndësishme ose një ndryshim i rëndësishëm i rrethanave, gjë që ndikon në këtë vlerësim, dhe që është nën kontrollin e qiramarrësit.

Norma rritëse e huamarrjes. Normat e skontimit të përdorura për përcaktimin e detyrimeve të qirasë. Njësia Raportuese përdor normën e saj rritëse të huamarrjes si bazë për llogaritjen e normës së skontimit sepse norma e interesit e nënkuptuar në qira nuk mund të përcaktohet lehtësisht.

6. Vlerësimet dhe gjykimet në zbatimin e politikave kontabël (vazhdim)**Norma rritëse e huamarrjes (vazhdim)**

Nga përdorimi i normës rritëse të huamarrjes përcaktohen faktorët e mëposhtëm: norma e interesit referencë specifike për monedhën dhe diferenca individuale e kredisë. Në normën referencë të interesit merret parasysh rreziku i kursit të këmbimit specifik për vendin. Diferenca e kredisë është përqindja e normës së interesit në rritje të huamarrjes që mbulon rreziqet individuale të kontratës përkatëse të qirasë.

7. Administrimi i rrezikut financiar

Njësia Raportuese monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të rrezikut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e rrezikut. Këto rreziqe përfshijnë rrezikun e tregut (rreziku i monedhës, rreziku i normave të interesit), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Objektivat kryesore të funksionit të administrimit të rrezikut financiar janë vendosja e kufijve të rrezikut dhe më pas të sigurohet që ekspozimi ndaj rreziqeve të mbetet brënda këtyre kufijve. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme, në mënyrë që të minimizohen rreziqet operationale dhe ligjore. Njësia raportuese nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre rreziqeve.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin tre tipe rreziku:

- Rreziku nga ndryshimet në kurset e këmbimit – rreziku që vlera e një instrumenti financiar të luhatet për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor.
- Rreziku i normës së interesit të vlerës së drejtë - rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut.
- Rreziku i çmimit - rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut, a janë ato ndryshime të shkaktuara nga faktorë specifikë për instrumentin individual ose emetuesin e tij ose faktorët që ndikojnë në të gjitha instrumentet e tregtuara në treg.

Rreziku i tregut mund të sjellë jo vetëm potencial për humbje, por edhe mundësinë për fitim.

Drejtimi përcakton kufijtë mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, i cili monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut.

Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut të përfshira më poshtë bazohen në një ndryshim në një faktor ndërkohë që mbajnë të gjithë faktorët e tjerë konstant. Në praktikë kjo nuk ka gjasa të ndodhë dhe ndryshimet në disa nga faktorët mund të lidhen - për shembull, ndryshimet në normën e interesit dhe ndryshimet në normat e monedhës së huaj.

Rreziku i monedhës

Njësia Raportuese ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe lind rreziku prej luhatjes së kurseve të këmbimit. Për këtë arsye, luhatjet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja mund të ndikojnë nivelin e kapitalit të aksionerëve si rezultat kjo i përket thim të tij në monedhën lokale. Rreziku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet. Normat zyrtare sipas Bankës Qendrore (Lekë për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 ishin si më poshtë:

	2021		2020	
	Mesatare	Në mbyllje	Mesatare	Në mbyllje
Dollari amerikan (USD)	103.54	106.54	108.53	100.84
Njësia e monedhes BE (EUR)	122.44	120.76	123.77	123.7

Njësia Raportuese nënshkruan polica në Lekë, Euro ose USD. Ajo hyn në marrëveshje të risigurimit kryesisht në Euro dhe blen mallra dhe shërbime në Euro dhe Lekë ose në USD. Sigurimet, dëmet dhe reyervat janë krzesisht në monedhën e polices së nënshkruar. Prandaj dhe njësia raportuese është e ekspozuar nga rreziku i monedhës. Politikat dhe proceset e njësisë raportuese përqëndrohen në lehtësimin e rrezikut të monedhës, përmes balancimit të shumës së parave të gatshme të përdorura në çdo monedhë, kryesisht duke investuar në depozitat me afat për të përputhur detyrimet që rezultojnë në monedhat përkatëse.

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku i monedhës (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet e njësisë raportuese sipas monedhave në 31 dhjetor 2021 janë si më poshtë:

(Në '000 Lekë)	ALL	EUR	USD	Total
Aktivitet				
Aktive të risigurimit	991,511	1,559,385	4,954	2,555,850
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	1,845,640	1,466,422		3,312,062
Depozita me afat me banka	706,937	1,278,083	14,222	1,999,242
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera, neto	52,439	201,475	2,600	256,514
Aktive të tjera	1,315	74,816	-	76,131
Tatimi mbi të ardhurat i arkëtueshem	4,544	-	-	4,544
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	117,133	190,001	8,272	315,406
Totali i aktiveve financiare	3,719,520	4,770,182	30,048	8,519,749
Detyrimet				
Detyrime për kontratat e sigurimeve përfshirë rezervën për primet e pafituara	2,731,012	2,979,993	10,298	5,721,303
Detyrimet e qirasë	51,435	240,046		291,481
Depozita e risiguresit	749,149	527,814		1,276,963
Të pagueshme të sigurimeve dhe të tjera	133,126	220,426	7,386	360,938
Totali i detyrimeve financiare	3,664,722	3,968,279	17,684	7,650,685
Pozicioni monetar, neto	54,798	801,903	12,364	869,064

Aktivitet dhe detyrimet e njësisë raportuese sipas monedhave në 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

(Në '000 Lekë)	ALL	EUR	USD	Total
Aktivitet				
Aktive të risigurimit	969,081	1,696,364	6,292	2,671,737
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	1,689,697	1,167,273	-	2,856,970
Depozita me afat me banka	732,210	1,291,257	13,302	2,036,769
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera, neto	23,181	182,416	1,859	207,456
Aktive të tjera	629	75,083	-	75,712
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	66,399	223,462	15,633	305,494
Totali i aktiveve financiare	3,481,197	4,560,772	37,086	8,079,055
Detyrimet				
Detyrime për kontratat e sigurimeve përfshirë rezervën për primet e pafituara	2,445,338	3,126,638	9,238	5,581,214
Detyrimet e qirasë	42,055	276,515	-	318,570
Depozita e risiguresit	671,650	572,874	-	1,244,524
Të pagueshme të sigurimeve dhe të tjera	159,964	128,888	7,550	296,402
Totali i detyrimeve financiare	3,319,007	4,104,915	16,788	7,440,710
Pozicioni monetar, neto	162,190	530,940	20,298	713,428

Analiza e ndjeshmërisë

Tabela në vijim tregon me detaje ndjeshmërinë e njësisë raportuese në rritje dhe zvogëlim të lekut kundrejt valutave më të rëndësishme. Ky ndryshim në kurset e këmbimit është përdorur kur raportohet rrezikun e monedhës të huaj brenda vendit për personelin drejtues kryesor dhe paraqet vlerësimin e drejtimit të ndryshimit të arsyeshëm të mundshëm në kurset e këmbimit.

Për çdo analizë të ndjeshmërisë ndikimi i ndryshimit në një faktor të vetëm është treguar, me supozimet e tjera të pandryshuara.

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**Rreziku i monedhës (vazhdim)**

Analiza e ndjeshmërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021:

	Ndikimi	Shuma
EUR rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	7,868
EUR bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(7,868)
USD rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	124
USD bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(124)

Analiza e ndjeshmërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020:

	Ndikimi	Shuma
EUR rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	45,586
EUR bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(45,586)
USD rritet me 10% përkundrejt Lekut	Fitim	2,030
USD bie me 10% përkundrejt Lekut	Humbje	(2,030)

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe nga rreziku që maturitetet e aktiveve që mbartin interes do të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes dhe që janë përdorur për të financuar këto aktive. Kohëzgjatja brënda së cilës norma e interesit e një instrumenti financiar qëndron e fiksuar përcakton edhe shkallën e rrezikut të normës së interesit ndaj të cilit ekspozohet instrumenti financiar. Profili i normës së interesit të instrumenteve financiare me interes të Njesisë Raportuese siç raportohet më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	2021	2020
Instrumente me normë fikse		
<i>Aktive financiare bartëse të interesit</i>		
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	3,312,062	2,856,970
Depozita me afat me banka	1,999,242	2,036,769
<i>Detyrime financiare bartëse të interesit</i>		
Depozitat e risigurimit	1,276,963	1,244,524
Totali	4,034,341	3,649,215

Një ndryshim me 100 pikë bazë në normat e interesit do të kishte rritur ose ulur kapitalin me 258,329 mijë lekë pas tatimit (2020: 866 mijë lekë). Kjo analizë supozon se të gjithë variablat e tjerë, veçanërisht kursi i këmbimit valutor, mbeten konstante.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë i referohet rrezikut që pala tjetër do të dështojë në obligimet e saj kontraktuale duke rezultuar në humbje financiare për njësinë raportuese. Përgjatë kursit normal të biznesit, teksa arkëtohen primet, këto fonde investohen për të shlyer obligimet e ardhshme të policave. Njësia raportuese ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë përmes titujve të borxhit të mbajtur deri në maturim, depozitave me afat, të arkëtueshmeve të sigurimit dhe kundërpartitë e risigurimit.

Njësia raportuese ka vendosur procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave partnerët e risigurimit duhet të kenë vlerësime BBB- ose më të larta sipas S&P apo Moody dhe të plotësojnë kërkesat e VIG përta i përket Rregullave të Sigurisë për Risigurimet. Njësia raportuese ka miratuar politika investimesh për të monitoruar rregullisht ekspozimin e rrezikut të kredisë nëpërmjetë monitorimit të ekspozimit të aktiveve të mbajtura për investim dhe depozitat në banka të palëve të treta. Ekspozimi maksimal i njësisë raportuese ndaj rrezikut të kredisë sipas pozicionit financiar është si më poshtë. Cilësia e aktiveve dhe detyrimeve financiare dhe të sigurimit do të paraqitet në shënimet përkatëse.

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku i kredisë (vazhdim)

	Shënimi	2021	2020
Aktive të risigurimit	16	2,555,850	2,671,737
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	17	3,312,062	2,856,970
Depozita me afat me banka	18	1,999,242	2,036,769
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera	20	256,514	207,456
Aktive të tjera	21	76,131	75,712
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	22	315,406	305,494
Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kreditit		8,515,205	8,154,138

Njësia raportuese nuk ka identifikuar asnjë indikacion objektiv për zhvlerësim e aktiveve të tjera financiare në datën e raportimit. Aktive të tjera përfshijnë paradhëniet që u jepen agentëve për tarifën e licencës. Aktivët e tjera financiare si ekuivalentët e mjeteve monetare, depozitat me afat dhe aktiveve të tjera konsiderohen as të vonuara as të zhvlerësuar.

Rreziku i kredisë nuk zbutet nga kolaterali për të gjitha instrumentet financiare që presin nga aktivët e risigurimit të linjës së biznesit MTPL me një risigures për të cilin është krijuar një depozitë risigurimi për të mbuluar rrezikun e kredisë. Njësia Raportuese strukturon nivelet e rrezikut të kredisë që ndërmerr duke vlerësuar marrëdhëniet dhe duke vendosur kufizime në shumën e rrezikut të pranuar në lidhje me palët ose grupet e kundërpalëve.

Kufijtë në nivelin e rrezikut të kredisë miratohen rregullisht nga drejtimi. Rreziqe të tilla monitorohen në baza rrotulluese dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor, ose më të shpeshtë. Normat e brendshme të aktiveve të risigurimit janë paraqitur në shënimin 16.

Njësia Raportuese ofron informacione shpjeguese mbi përqendrimin e rrezikut sipas gjeografisë si më poshtë:

Analiza sipas shtetit

31 dhjetor 2021	Shqipëri	Kosovë	Austri	Republika Çeke	Shtete të tjera Europiane
Aktive Financiare					
Aktive të risigurimit	-	-	1,501,829	988,977	65,044
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	2,478,825	833,237	-	-	-
Depozita me afat me banka	813,154	1,186,088	-	-	-
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera	117,979	138,535	-	-	-
Aktive të tjera	61,036	15,095	-	-	-
	3,470,994	2,172,955	1,501,829	988,977	65,044

31 dhjetor 2020	Shqipëri	Kosovë	Austri	Republika Çeke	Shtete të tjera Europiane
Aktive Financiare					
Aktive të risigurimit	-	-	1,475,676	1,178,310	17,751
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	2,049,408	807,562	-	-	-
Depozita me afat me banka	901,741	1,135,028	-	-	-
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera	59,660	147,796	-	-	-
Aktive të tjera	60,876	14,836	-	-	-
	3,071,685	2,105,222	1,475,676	1,178,310	17,751

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**Rreziku i kredisë (vazhdim)**

Drejtimi i Njesisë Raportuese rishikon analizën e vjetërsisë së të arkëtueshmeve të papaguara të sigurimit dhe ndjek tepricat e vonuara. Prandaj, drejtimi e konsideron të përshtatshme të japë informacione të vjetra dhe informacione të tjera në lidhje me rrezikun e kredisë siç shpaloset në shënimin 20. Rreziku i kredisë për instrumentet financiare jashtë bilancit përcaktohet si mundësia e mbajtjes së një humbjeje si rezultat i dështimit të një pale tjetër në një instrument financiar të kryejë në përputhje me kushtet e kontratës. Ekspozime të tilla nuk janë të rëndësishme.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që njësia raportuese nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Rreziku i likuiditetit është një rrezik i moderuar i brendshëm për aktivitetin e biznesit të Njesisë Raportuese sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Njësia Raportuese do të kërkonte shuma të konsiderueshme brenda një periudhe të shkurtër duke tejkaluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballej me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse. Njësia raportuese menaxhon rrezikun e likuiditetit përmes monitorimit të vazhdueshëm të fluksit të parasë të parashikuar dhe atij aktual, duke përputhur maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Aktivitet dhe detyrimet financiare më 31 dhjetor 2021 të detajuara sipas maturitetit paraqiten më poshtë:

Shumat e detajuara më poshtë lidhen me maturimet kontraktuale, por në praktikë ato flukse monetare hyrëse ose dalëse nuk pritet të ndodhin në këto intervale.

	Më pak se 6 muaj	Ndërmjet 6 muaj dhe 1 vit	Ndërmjet 1 vit dhe 10 vjet	Total
Aktivitet				
Aktive të risigurimit	437,837	1,141,086	976,927	2,555,850
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	158,340	346,865	2,806,857	3,312,062
Depozita me afat me bankat	233,654	913,757	851,831	1,999,242
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera, neto	201,375	48,819	6,320	256,514
Aktive të tjera	1,315	-	74,816	76,131
Mjete monetare dhe ekuivalentë	315,406	-	-	315,406
Totali i aktiveve financiare	1,347,927	2,450,527	4,716,751	8,515,205
Detyrime				
Detyrime për kontratat e sigurimeve	728,601	1,521,086	1,738,657	3,988,344
Rezerva për primet e pafituara	870,714	841,710	20,535	1,732,959
Detyrim për qira	5,930	41,713	243,838	291,481
Depozita e risiguresit	727,030	282,483	267,450	1,276,963
Të pagueshme të sigurimeve dhe të tjera	352,220	3,431	5,287	360,938
Totali i detyrimeve financiare	2,684,495	2,690,423	2,275,767	7,650,685
Pozicioni i likuiditetit neto	(1,336,568)	(239,896)	2,440,984	864,520

Në pozicionin e likuiditetit të Njesisë Raportuese, të shpalosur më lart si për vitin 2021 ashtu edhe për vitin 2020, janë paraqitur përkatësisht hyrjet dhe daljet e parave të pritshme të paskontuara. Për sa i përket detyrimeve të kontratave të sigurimit, flukset dalëse të parave të pritshme të paskontuara janë shpalosur duke supozuar se periudha maksimale e detyrueshme e shlyerjes, sipas legjislacionit në fuqi, do të respektohet. Megjithatë, mund të ndodhin situata kur Njësia Raportuese dhe paraqitësi i kërkesës nuk ndajnë të njëjtat pikëpamje në lidhje me vlerësimin e kërkesës, mosmarrëveshja zgjidhet më tej përmes një procesi gjyqësor. Edhe pse në rastin e fundit zgjidhja shtyhet ndjeshëm, nuk është e mundur të bëhen parashikime të sakta.

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet financiare më 31 dhjetor 2020 të detajuara sipas maturitetit paraqiten më poshtë:

	Më pak se 6 muaj	Ndërmjet 6 muaj dhe 1 vit	Ndërmjet 1 vit dhe 10 vjet	Total
Aktivitet				
Aktive të risigurimit	1,713,072	525,460	433,205	2,671,737
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	42,818	203,538	2,610,614	2,856,970
Depozita me afat me bankat	479,616	754,206	802,947	2,036,769
Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera, neto	177,399	19,168	10,889	207,456
Aktive të tjera	629	-	75,083	75,712
Mjete monetare dhe ekuivalentë	305,494	-	-	305,494
Totali i aktiveve financiare	2,719,028	1,502,372	3,932,738	8,154,138
Detyrime				
Detyrime për kontratat e sigurimeve	2,117,423	843,199	985,143	3,945,765
Rezerva për primet e pafituara	798,486	813,457	23,506	1,635,449
Detyrim për qira	20,119	37,581	260,870	318,570
Depozita e risiguruesit	677,236	281,655	285,633	1,244,524
Të pagueshme të sigurimeve dhe të tjera	268,590	18,518	9,294	296,402
Totali i detyrimeve financiare	3,881,854	1,994,410	1,564,446	7,440,710
Pozicioni i likuiditetit neto	(1,162,826)	(492,038)	2,368,292	713,428

8. Administrimi i rrezikut të sigurimit

Njësia raportuese merr mbi vete rrezik të sigurimit përmes kontratave të sigurimit në të cilat merr parasysh rrezikun e humbjes nga personat apo organizatat që janë drejtpërdrejt subjekt i humbjes. Njësia raportuese është e ekspozuar ndaj pasigurisë që ka të bëjë me kohën, frekuencën dhe shkallën e dëmeve të lidhura me këto kontrata. Rreziku i sigurimeve lidhet me pasigurinë e aktivitetit të sigurimeve. Përbërësit më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Këto kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e niveleve të normave të primit të sigurimeve dhe përshtatshmërinë e provizioneve në lidhje me detyrimet e sigurimeve dhe bazën e kapitalit.

Rreziku i sigurimit është i pranishëm kur polica lëshohet përpara se ndonjë ngjarje e siguar të ketë ndodhur. Rreziku është që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara do të jenë më të larta se primit. Rreziku i rezervës përfaqëson rrezikun që niveli absolut i provizioneve teknike të vlerësohet ose që pretendimet aktuale do të luhaten rreth vlerës mesatare statistikore.

Menaxhimi i rreziqeve

Njësia raportuese menaxhon rrezikun përmes procedurave për shkrimin e primeve (prërfshirë limitet, aprovimet, politikën e cmimit, dizenjimin e produkteve) dhe strategjisë së risigurimit brënda kuadrit të një menaxhimi rreziku të përgjithshëm. Vendorsja e çmimeve bëhet bazuar në trendet dhe përvojat e kaluara. Ekspozimi menaxhohet duke pasur të dokumentuar limitet dhe kriteret e marrjes në sigurim. Risigurimet realizohen për t'i lehtësuar njësisë raportuese efektin e humbjeve të mundshme nga ngjarjet individuale të mëdha apo katastrofave si dhe për të siguruar akses te specialistë të rrezikut dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit shkruhen me risigures të aprovuar ose mbi bazën e një marrëveshje proporcionale ose mbi bazën e një marrëveshje të tejkallimit të humbjes.

Kapitali rregullator menaxhohet gjithashtu (edhe pse jo vetëm) duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Njësia Raportuese është e ekspozuar. Njësia raportuese shkruan polica për prona, detyrime dhe mjete motorike kryesisht për kohëzgjatje mbi 12 muaj. Rreziqet më të rëndësishme vijnë prej katastrofave natyrore, ndryshimeve klimatike dhe katastrofave të tjera (ngjarje me frekuencë të ulët dhe shkallë dëmi të lartë). Rrezik i përqëndruar vjen edhe prej një kontrate të vetme që i lëshohet policëmbajtësve të një tipi demografie të veçantë, brënda një zone gjeografike të caktuar ose tipeve të bizneseve tregtare. Ndryshueshmëria e rezultatit lehtësohet nëse portofoli përbëhet nga shumë rreziqe të ngjashme.

Më poshtë jepet një përmbledhje e koncentrimit të provizioneve për dëme sipas tipit të kontratës duke iu referuar detyrimeve të sigurimit:

	2021			2020		
	Risigurimi	Neto	Risigurimi	Neto	Risigurimi	Neto
Linja e biznesit						
Mjete motorike	2,544,923	(1,032,946)	1,511,978	2,389,706	(1,033,092)	1,356,614
Prona	1,341,634	(877,703)	463,932	1,466,500	(1,052,703)	413,797
Shëndeti dhe aksidentet	101,787	(25,524)	76,263	89,559	(29,137)	60,423
Totali	3,988,344	(1,936,172)	2,052,172	3,945,765	(2,114,932)	1,830,833

Përqendrimi i primeve sipas llojit të kontratës është përmbledhur më poshtë duke iu referuar detyrimeve të sigurimit:

	2021			2020		
	Bruto	Risigurimi	Bruto	Risigurimi	Bruto	Risigurimi
Linja e biznesit						
Mjete motorike	2,744,729	(1,146,506)	1,598,223	2,545,529	(1,067,098)	1,478,431
Prona	558,320	(447,278)	111,042	511,176	(403,826)	107,350
Shëndeti dhe aksidentet	470,049	(127,705)	342,344	453,782	(123,533)	330,249
Totali	3,773,098	(1,721,489)	2,051,609	3,510,487	(1,594,457)	1,916,030

8. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)**Menaxhimi i rreziqeve (vazhdim)**

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të sigurimit është paraqitur më poshtë. Përfaqëson shumën maksimale të siguruar për të gjitha policat e papaguara të sigurimit.

Vlera në milionë LEK	2021 Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të sigurimit*	2020 Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të sigurimit*
Linja e biznesit		
Mjete motorike	*Referohu më poshtë	*Referohu më poshtë
Prona	441,264	184,828
Shëndeti dhe aksidentet	19,766	50,658
Të tjera	5,528,291	5,733,547
Totali	5,989,321	5,969,033

* Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të sigurimit është në bazë bruto dhe nuk përfshin pjesën e risigurimit. Për mjetet motorike, ekspozimi bazohet në ligjin shqiptar (Nr. 10076 datë 12.02.2009) dhe në ligjin e vendit të aksidentit (Sigurimi me karton jeshil). Për MTPL, legjislacioni shqiptar “Nr. 10 076, datë 12 shkurt 2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 26, parashikon ekspozimet maksimale sipas llojit të aksidentit dhe dëmeve të shkaktuara si pasojë e një ngjarje të siguruar. Sa i përket sigurimit të kartonit jeshil, shumat minimale përcaktohen nga vendet ku ndodh aksidenti.

Njësia raportuese shkruan rreziqet e pronës, përgjegjësisë dhe motorike kryesisht gjatë kohëzgjatjes dymbëdhjetëmuajore. Rreziqet më të mëdha lindin nga fatkeqësitë natyrore, ndryshimet klimatike dhe katastrofat e tjera (ngjarjet me frekuencë të ulët dhe efekt të madh). Një përqendrim rreziku mund të lind gjithashtu nga një kontratë e vetme sigurimi e lëshuar për një tip të veçantë demografik të mbajtësit të policës, me një vendndodhje gjeografike ose me llojet e biznesit komercial. Njësia raportuese zbut ndryshueshmërinë relative të rezultatit nëse ka një portofol të madh të rreziqeve të ngjashme.

Dëmet aktuale të krahasuara me vlerësimet

Provizionet për koston përfundimtare të pritshme të shlyerjes së të gjitha kërkesave të ndodhura në lidhje me ngjarjet deri në atë datë, qoftë të raportuara apo jo, së bashku me shpenzimet e trajtimit të dëmeve, shumat e paguara më herët, bëhen në datën e raportimit. Detyrimi për kërkesat e raportuara (të raportuara por jo të paguara ose “RBNS”) vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh rrethanat e kërkesës, informacionin në dispozicion dhe dëshmitë historike të madhësisë së pretendimeve të ngjashme. Rezervat e dëmeve rishikohen rregullisht dhe përditësohen kur lindin informacione të reja.

Vlerësimi i dëmeve të ndodhura, por jo të raportuara (“IBNR”) në përgjithësi i nënshtrohet një shkallë më të lartë pasigurie sesa kërkesat e raportuara. Aktuarët e njësive raportuese kryesisht vlerësojnë provizionet e IBNR duke përdorur teknika statistikore ekstrapolim të dhënave historike me qëllim të vlerësimit të kostove përfundimtare të dëmeve.

Duke qenë se këto metoda përdorin informacion historik të zhvillimit të dëmeve, ato supozojnë se modeli i zhvillimit të dëmeve historike do të shfaqet përsëri në të ardhmen. Ka raste që kjo nuk mund të jetë gjithmonë kështu, për të cilat, për aq sa ato mund të identifikohen, lejohet që të modifikohet metoda e përdorur.

Këto rastet mund të jenë:

- Ekonomike, legale politike dhe sociale (duke rezultuar në nivele të ndryshme të inflacionit sesa ato të pritura);
- Ndryshime në përpilimin e kontratave;
- Lulahje të rastit, duke përfshirë ndikime të mëdha tek humbjet.

Dispozitat e IBNR fillimisht vlerësohen në një nivel bruto dhe kryhet një llogaritje e veçantë për të vlerësuar madhësinë e rikuperimit të risigurimeve.

8. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

Tabela e mëposhtme tregon dëmet aktuale të ndodhura të krahasuara me vlerësimet e mëparshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020:

	2021	2020
RBNS		
Vlerësimet fillestare për dëmet	2,702,768	2,399,840
Rezultatet aktuale në lidhje me dëmet e ngjara	(793,553)	(755,597)
Vlerësimet përfundimtare për dëmet	(1,872,323)	(1,787,449)
Shmangia në Lekë	36,892	(143,206)
Shmangia në %	1.36%	-5.97%
IBNR		
Vlerësimet fillestare për dëmet	859,253	771,793
Rezultatet aktuale në lidhje me dëmet e ngjara	(119,806)	(178,251)
Vlerësimet përfundimtare për dëmet	(386,805)	(446,000)
Shmangia në Lekë	352,643	147,542
Shmangia në %	41.04%	19.12%

Testi i mjaftueshmërisë i detyrimeve

Detyrimet e sigurimit llogariten duke përdorur supozime historike. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve për sigurimin e jo-jetës është i kufizuar në pjesën e paskaduar të kontratave ekzistuese. Ai kryhet duke krahasuar vlerën e pritshme të dëmeve dhe shpenzimeve që i atribuohen periudhës në fuqi me shumën e primeve të pafituara në lidhje me këto polica pas zbritjes së kostove të drejtpërdrejta që kanë të bëjnë me sigurimin. Flukset monetare të pritshme në lidhje me kërkesat dhe shpenzimet vlerësohen duke ju referuar përvojës gjatë pjesës së skaduar të kontratës, të rregulluar për humbjet individuale të cilat nuk priten të përsëriten.

8. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

Testi i mjaftueshmërisë i detyrimeve (vazhdim)

Tabela e mëposhtme tregon zhvillimin gradual të vlerësimit të dëmeve përfundimtare sipas pretendimeve të bëra gjatë vitit. Vlerësimi ndryshoi në periudha individuale në varësi të kërkesave aktuale të paguara. Shuma bruto e provizioneve është totali i provizioneve të RBNS. Krahasimi i vlerësimeve statistikore të provizioneve të mjaftueshme me shumën bruto të provizioneve sugjeron nivele të mjaftueshme të provizioneve për dëmet.

	2021	2020	2019	2018	2017	2016	2015	2014	2013	2012	Total
Vlerësim i dëmeve progresive											
- Në fund të vitit të marrjes në sigurim	1,436,198	1,395,099	1,610,941	2,138,729	1,178,043	820,647	1,098,548	1,013,887	436,325	3,026,629	14,155,046
- Një vit më vonë		1,514,479	2,051,881	2,897,441	1,332,081	1,172,063	1,501,358	1,286,341	549,520	2,767,314	15,072,478
- Dy vite më vonë			2,196,545	2,972,131	1,352,774	1,279,996	1,561,735	1,367,752	662,045	3,375,299	14,768,277
- Tre vite më vonë				2,976,369	1,375,044	1,274,747	1,612,354	1,378,649	658,847	3,522,087	12,798,097
- Katër vite më vonë					1,395,555	1,285,041	1,617,997	1,402,751	684,915	3,531,434	9,917,693
- Pesë vite më vonë						1,331,106	1,626,451	1,410,381	700,632	3,572,666	8,641,236
- Gjashtë vite më vonë							1,647,982	1,372,251	697,462	3,601,650	7,319,345
- Shtatë vite më vonë								1,386,777	731,851	3,593,979	5,712,607
- Tetë vite më vonë									728,281	3,622,583	4,350,864
- Nëntë vite më vonë										3,645,599	3,645,599
Vlerësimi i kërkesave kumulative	1,436,198	1,514,479	2,196,545	2,976,369	1,395,555	1,331,106	1,647,982	1,386,777	728,281	3,645,599	18,258,891
Pagesat kumulative	864,892	1,110,989	1,663,032	2,547,986	1,278,726	1,185,097	1,541,542	1,296,682	642,371	3,182,390	15,313,707
Vlera e njohur në pasqyrën e pozicionit financiar	571,306	403,490	533,513	428,383	116,829	146,009	106,440	90,095	85,910	463,209	2,945,184

Drejtimi rishikon vlerësimin për dëmet dhe supozimet duke u bazuar në zhvillimet e dëmeve aktuale dhe bën rregullimet e duhura në metodologjinë e vlerësimit të dëmeve. Në vitin aktual, ka pasur një besim më të madh ndaj metodologjive aktuariale të tilla si trekëndëshi i dëmeve.

Supozimet që kanë efektin më të madh në matjen e detyrimeve të sigurimeve të jo-jetës janë si më poshtë:

Raporti i pritshëm i dëmeve. Raporti i pritur i dëmeve përfaqëson raportin e dëmeve të paguara dhe kërkesave të pritshme të shkaktuara për primet e fituara duke përjashtuar pjesën e risiguruesit në primet e fituara dhe kërkesat e paguara dhe të pritura (ndryshimet në IBNR dhe RBNS). Supozimet në lidhje me raportet e pritshme të dëmeve për vitin e fundit të aksidentit, sipas klasës së biznesit, kanë më së shumti ndikim në nivelin e provizioneve.

Faktorët limit. Për bizneset me limte të larta, niveli i provizionit ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga vlerësimi i zhvillimit të dëmeve nga viti i fundit i zhvillimit për të cilin ka të dhënat historike deri në zgjidhjen përfundimtare. Këto faktorë vlerësohen me maturi në bazë të përvojës.

Skontime. Provizionet e dëmeve të jo-jetës nuk janë skontuar.

8. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

Zhvillimi i dëmeve. Dëmet e ndodhura përgjithësisht përpunohen nga njësia raportuese për një periudhë të shkurtër dhe normalisht mbyllen me një vit. Kërkesat e kartonit jeshil kanë tendencë të kenë periudhë më të gjatë të por jo të tejkalojë shumë gjatë një vit. Në përvojën e njësive raportuese, zhvillimi i dëmeve nuk ndryshon materialisht nga vlerësimet fillestare.

Supozime dhe sensitiviteti. Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kuantitative të sensitivitetit. Njësia Raportuese përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë treguesë të tillë si raporti i humbjes së pritur.

Marrëveshjet e risigurimit të Njësive Raportuese përfshijnë “quota share”, “excess”, “stop-loss” ose “mbulimin e katastrofave”. Efekti i një marrëveshjeje të tillë risigurimi është se Njësia Raportuese nuk duhet të pësojë humbje totale të sigurimeve neto prej më shumë se 250,000 mijë euro në një vit të caktuar, që është ekspozimi maksimal për MTPL dhe Prona dhe Inxhinierike. Linjat e tjera të biznesit kanë ekspozime më të ulëta. Përveç programit të përgjithshëm të risigurimit të Njësive Raportuese, klientëve u lejohej blerja e sigurimit shtesë nga risigurimet.

Njësia Raportuese e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihen në pasqyrat e veçanta të pozicionit financiar. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Një pamje e përgjithshme e analizës së sensitivitetit që tregon impaktin në fitimin përpara taksave jepet më poshtë. Për një sensitivitet të tillë, shfaqet ndikimi i një ndryshimi në një faktor të vetëm, me supozimet e tjera të pandryshuara.

	Ndikimi	2021	Ndikimi	2020
Raporti i dëmeve		43%		57%
5% rritje në raportin e dëmeve	Loss	35,594	Loss	32,838
5% rënie në raportin e dëmeve	Gain	35,594	Gain	32,838
Raporti i shpenzimeve		46%		38%
5% rritje në raportin e shpenzimeve	Loss	24,138	Loss	21,864
5% rënie në raportin e shpenzimeve	Gain	24,138	Gain	21,864
Raporti i kombinuar		89%		95%
5% rritje në raportin e kombinuar	Loss	59,732	Loss	54,702
5% rënie në raportin e kombinuar	Gain	59,732	Gain	54,702

9. Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Struktura e kapitalit të Njësive Raportuese konsiston në kapital që i atribuohet mbajtësve të kapitalit të njësive raportuese, dhe përfshin kapitalin e paguar, rezervat dhe fitimin e pashpërndarë. Njësia Raportuese menaxhon kapitalin për të siguruar që nivelet e kërkuara të kapitalit janë të mjaftueshme për njësien raportuese, në mënyrë që të bëjë të mundur vijimësinë e aktivitetit dhe përputhshmërinë me kërkesat për kapital të rregullatorëve, ndërsa maksimizon kthimin për aksionerët përmes optimizimit të raportit të borxhit me kapitalin. Më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, kapitali aksioner i njësive raportuese është në përputhje me kërkesat mbi kapitalin e paguar të rregullatorëve të sigurimeve.

Në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve", Shoqëritë e sigurimeve në Shqipëri llogarisin kapitalin rregullator në datën e raportimit duke e krahasuar atë me aftësinë paguese të kërkuar. Kapitali i shoqërive të sigurimit duhet të paktën të jetë shuma më e lartë e fondit të garancisë të njësive raportuese në datën e raportimit dhe 150% e aftësisë paguese të kërkuar në përputhje me Ligjin e Sigurimeve. Në datën e raportimit 31 dhjetor 2021, aftësia paguese e njësive raportuese është 1,000,764 mijë Lekë (2020: 944,455 mijë Lekë) (Skedulet suplementare).

Më poshtë është paraqitur administrimi i kapitalit për aktivitetin shqiptar.

	Note	2021	2020
Kapitali	23, 24	1,384,201	1,309,356
Aftësia paguese e njësive raportuese	Skedulet suplementare	992,745	944,455
Minimumi i kërkuar i aftësisë paguese		291,326	194,860
150% e minimumit të kërkuar të aftësisë paguese margin (pika 3 e Rregullimit nr. 111)		291,326	292,291
Aftësia paguese e kërkuar (pika 81 e Ligjit të sigurimeve)		370,000	370,000
Në % mbi kapitalin		270%	255%
Fondi i garancisë	18	421,790	405,959

9. Menaxhimi i rrezikut të kapitalit (vazhdim)

Njësia Raportuese ka kërkesa të veçanta për menaxhimin e kapitalit në degën e tij në Kosovë. Dega menaxhon shumën e kapitalit themeltar për të siguruar që të ruhen nivele të përshtatshme që Dega të jetë në gjendje të vazhdojë si vijimësi dhe të jetë në përputhje me kërkesat e kapitalit të rregullatorëve, duke maksimizuar kthimin për palët e interesuara përmes një optimizimi të balancave të borxhit dhe kapitalit. Më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, Dega përmbushi të gjitha kërkesat për kapital, duke përfshirë marzhin e aftësisë pagueuse dhe raportin e aktiveve që mbulojnë detyrimet e kontratave të sigurimit. Kapitali i autorizuar i degës klasifikohet si rezervë tjetër ligjore e sigurimeve në kapital, siç përshkruhet në shënimin 24.

Rreziqe të tjera

Ndryshimet në rregulloret qeveritare për segmentet e tregut në të cilat njësia raportuese operon mund të prekin përfitueshmërinë e saj. Tregu i sigurimeve është subjekt i mbikqyrjeve gjithëpërfshirëse dhe zhvilluese. Qëllimi kryesor i këtyre rregulloreve është mbrojtja e policëmbajtësve. Ndryshimet në ligjet dhe rregulloret aktuale të sigurimit mund të ndikojnë mënyrën me të cilën njësia raportuese drejton aktivitetin e biznesit dhe produktet që ofron. Për më tepër, përshtatja dhe amendimi i herë pas herëshëm i ligjeve të sigurimit ose rregulloreve mund t'i bëjë ato më kufizuese ose të rezultojnë në kosto më të larta sesa kërkesat në aktuale.

10. Vlera e drejtë

Matjet e vlerës së drejtë për qëllime matjeje dhe / ose prezantimi analizohen sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dy janë teknikat e vlerësimit me të gjitha informacionet materiale të vëzhgueshme për aktivin ose pasivin, ose drejtpërdrejt (dmth. si çmime) ose indirekt (të derivuara nga çmimet); dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen në të dhënat e vëzhgueshme të tregut që është, inputet e padukshme).

Drejtimi aplikon gjykimin për kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse një matje e vlerës së drejtë përdor informacione të vëzhgueshme që kërkojnë një rregullim të rëndësishëm, kjo matje është një matje e Nivelit 3. Rëndësia e një informacioni vlerësohet në matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e saj.

Nuk ka aktive të cilat janë vlerësuar me matje të papërsëritur të vlerës së drejtë.

(a) Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë

Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë janë ato që standardet e kontabilitetit kërkojnë ose lejojnë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportuese:

Pronat e investuara. Njësia Raportuese mat pronat e investuara me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi. Vlera e drejtë është çmimi që do të merret për të shitur një aktiv ose të paguar për të transferuar një pasiv në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Matja e vlerës së drejtë bazohet në supozimin se transaksioni për të shitur aktivin ose transferimin e detyrimit kryhet ose në tregun kryesor të aktivit ose pasivit ose në mungesë të një tregu kryesor, në tregun më të favorshëm për aktivin ose detyrimin.

Aktivitet afatgjatë materiale të investuara përbëhen nga dy prona komerciale me qëllim dhënien e qirasë të palët e treta. Ndërtesat përfshijnë 6 prona të cilat janë në përdorim nga Njësia Raportuese. Vlera e drejtë e aktiveve afatgjatë materiale të investuara përcaktohet nga vlerësues të jashtëm të pavarur të pronës me kualifikime profesionale të njohura dhe përvojë të fundit në vendin dhe kategorinë e pasurisë që vlerësohet. Në lidhje me pronat e investuara që maten dhe paraqiten me vlerën e drejtë në pasqyrat financiare, ju lutemi referojuni shënimit 14 dhe 11.

Frekuenca e rivlerësimeve varet nga ndryshimet në vlerën e drejtë të ndërtesave dhe pronave të investuara që rivlerësohen. Kur vlera e drejtë e një aktivi të rivlerësuar ndryshon materialisht nga vlera kontabël e tij, kërkohej një rivlerësim i mëtejshëm. Pronat e investuara mund të pësojnë ndryshime të rëndësishme dhe të paqëndrueshme në vlerën e drejtë, kështu që Njësia Raportuese kryen rivlerësim vjetor. Për ndërtesat dhe pronat e investuara Njësia Raportuese ka vlerësuar se rivlerësimet e shpeshta nuk janë të nevojshme pasi nuk ka ndryshime të rëndësishme në vlerën e drejtë. Në vend të kësaj, ato rivlerësohen çdo tre vjet. Megjithatë, kur ka tregues të ndryshimeve të rëndësishme në vlerën e drejtë, bëhet vlerësimi vjetor.

10. Vlera e drejtë (vazhdim)

(a) Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë (vazhdim)

Tabela e mëposhtme jep hierarkinë e matjes së vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të bankës të matura me vlerën e drejtë:

			Duke përdorur matjen e vlerës së drejtë							
			2021			2020				
			Totali	Çmimet e kuotuar në tregjet aktive	Inpute të rëndësis hme të vëzhgues hme	Inpute të rëndësis hme të pavëzhgu eshme	Totali	Çmimet e kuotuar në tregjet aktive	Inpute të rëndësis hme të vëzhgues hme	Inpute të rëndësis hme të pavëzhgu eshme
Aktivitet e matura me vlerën e drejtë:	Data e vlerësimit	Shënim	(Niveli 1)	(Niveli 2)	(Niveli 3)	(Niveli 3)	(Niveli 1)	(Niveli 2)	(Niveli 2)	(Niveli 3)
Prona të investuara	5 janar 2022	13	51,025	-	-	51,025	68,500	-	-	68,500
Ndërtesa	30 dhjetor 2019	11	222,774	-	-	222,774	222,338	-	-	222,338
			273,799	-	-	273,799	290,838	-	-	290,838

b) Aktivet dhe detyrimet që nuk maten me vlerën e drejtë, për të cilat vlera e drejtë është e shpalosur

Vlera e drejtë e analizuar sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve që nuk maten me vlerën e drejtë janë si më poshtë. Të arkëtueshmet e sigurimeve nuk përfshihen pasi për ato nuk kërkohet vlera e drejtë.

	Hua dhe të arkëtueshme	Vlera kontabël totale	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2021			
Depozita me afat me bankat (Niveli 1)	1,999,242	1,999,242	1,987,314
Aktive të tjera (Niveli 3)	74,816	74,816	74,816
Mjete monetare dhe ekuivalentë (Niveli 1)	315,406	315,406	315,406
Letra me vlerë me kosto të amortizuar (Niveli 2)	3,312,062	3,312,062	3,409,340
31 dhjetor 2020			
Depozita me afat me bankat (Niveli 1)	2,036,769	2,036,769	2,037,361
Aktive të tjera (Niveli 3)	75,083	75,083	75,083
Mjete monetare dhe ekuivalentë (Niveli 1)	305,494	305,494	304,338
Letra me vlerë me kosto të amortizuar (Niveli 2)	2,856,970	2,856,970	3,014,805

Aktivitet financiar të mbajtura me koston e amortizuar. Vlera e drejtë e instrumenteve me norma të luhatshme dhe instrumenteve afatshkurtër është normalisht vlera e tyre kontabël. Vlera e drejtë e vlerësuar e instrumentave të normës fikse të interesit bazohet në flukset monetare të ardhshme të parashikuara që priten të skontohen me normat aktuale të interesit për instrumente të reja me rreziqe të ngjashme kreditore dhe maturime të mbetura. Vlera e drejtë e investimeve të mbajtura deri në maturim është përcaktuar në bazë të çmimeve të kuotuar të shpallura nga Banka e Shqipërisë për të njëjtin instrument duke marrë në konsideratë maturim të ngjashëm me maturimin e instrumenteve të mbajtura nga njësi raportuese. Detyrimet financiare të Njesisë Raportuese janë afatshkurtra dhe vlerat e tyre të drejta zakonisht janë të barabarta me vlerat e tyre të drejta.

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance group sh.a.
Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare – 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

11. Aktivët afatgjatë materiale

	Ndërtesa	Përmirësime të ambjenteve të marra me qira	Mjete motorike	Pajisje kompjuterike dhe zyre	Totali
Kosto ose vlerësim					
Në 1 janar 2020	364,295	8,816	103,334	243,105	719,550
Shtesa	-	2,305	2,839	11,512	16,656
Pakësime	-	-	(19,714)	(1,003)	(20,717)
Fitim/Humbje nga përkthimi	-	134	508	1,474	2,116
Në 31 dhjetor 2020	364,295	11,255	86,967	255,088	717,605
Shtesa	-	36	6,096	8,105	14,237
Pakësime	-	-	-	(252)	(252)
Transferime	18,585	-	-	-	18,585
Shitje	-	-	-	(9,492)	(9,492)
Në 31 dhjetor 2021	382,880	11,291	93,063	253,449	740,683
Amortizimi i akumuluar					
Në 1 janar 2020	130,255	2,087	70,953	185,939	389,234
Shpenzimi i vitit	11,702	887	6,382	16,811	35,782
Amortizim për pakësime	-	-	(19,556)	(719)	(20,275)
Fitim/Humbje nga përkthimi	-	33	220	957	1,210
Në 31 dhjetor 2020	141,957	3,007	57,999	202,988	405,951
Shpenzimi i vitit	17,039	883	6,712	8,601	33,235
Amortizim për pakësime	-	-	-	(256)	(256)
Amortizim për transferime	1,110	-	-	-	1,110
Amortizim për shitje	-	-	(6,156)	(955)	(7,111)
Në 31 dhjetor 2021	160,106	3,890	58,555	210,378	432,929
Vlera Kontabël neto					
Në 31 dhjetor 2020	222,338	8,248	28,968	52,100	311,654
Në 31 dhjetor 2021	222,774	7,401	34,508	43,071	307,754

Vlera e drejtë e ndërtesave është përcaktuar nga ekspertë të jashtëm të cilët kanë kualifikimet dhe eksperiencën e duhur në kategorinë përkatëse të aktiveve që kanë vlerësuar. Vlerësuesit e pavarur përcaktojnë çdo 3 vjet vlerën e drejtë të pronave të përdorura të Shoqërisë për realizimin e aktivitetit. Matja e vlerës së drejtë për ndërtesat ka qenë e kategorizuar si vlera e drejtë e nivelit 3 dhe nivelit 2. Vlera e drejtë e ndërtesave sipas raportit të vlerësimit të realizuar në dhjetor 2020 është 222,339 mijë lekë. Gjatë vitit 2021 ka ndodhur një transferim nga prona e investuar në ndërtesa të vetëpërdorura. Ngarkesa e amortizimit njihet si “shpenzime administrative” në fitim ose humbje. Vlerësimet e mëvonshme nuk treguan për luhajtje të rëndësishme në vlerën e drejtë.

12. Aktive afatgjata jo-materiale

Aktivitet jo-materiale më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

Kosto	Programe kompjuterike
Në 1 janar 2020	115,985
Shtesa	9,798
Pakësime	(5,181)
Fitim/Humbje nga përkthimi	752
Në 31 dhjetor 2020	121,354
Shtesa	10,175
Pakësime	-
Fitim/Humbje nga përkthimi	(1,183)
Në 31 dhjetor 2021	130,346
Amortizimi i akumuluar	
Në 1 janar 2020	51,717
Shpenzimi i vitit	12,481
Pakësime	(434)
Fitim/Humbje nga përkthimi	156
Në 31 dhjetor 2020	63,920
Shpenzimi i vitit	13,718
Pakësime	-
Fitim/Humbje nga përkthimi	(449)
Në 31 dhjetor 2021	77,189
Vlera Kontabël neto	
Në 31 dhjetor 2020	57,434
Në 31 dhjetor 2021	53,157

13. Aktivitet e mbajtura për investim

	2021	2020
Gjendja më 1 janar	68,500	72,850
Ndryshimi nga vlera e drejtë	(17,475)	(4,350)
Gjendja më 31 Dhjetor	51,025	68,500

Vlerësimi i pronave kryhet nga një ekspert i pavarur bazuar në Standardet Evropiane të Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Standardeve Ndërkombëtare. Metoda e vlerësimit e përdorur është krahasimi i drejtpërdrejtë, ndërsa prona vlerësohet bazuar në çmimin e shitjes së pronave mjaft të ngjashme (vendndodhja e njëjtë, përdorimi dhe madhësia e pronave) në tregun shqiptar. Inputet e nivelit 2 përdoren nga eksperti i vlerësimit duke marrë parasysh çmimet e shitjes të vëzhgueshme për madhësi, natyrë dhe veti të ngjashme. Sidoqoftë, çmimet e shitjes ndryshojnë në treg. Një rritje / (ulje) prej 10% e çmimeve të shitjes në treg do të kishte një efekt prej 5,102 mijë lekësh më 31 dhjetor 2021 (31 dhjetor 2020: 6,850 mijë lekë).

14. Aktive më të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë

Njësia Raportues jep me qira zyra të ndryshme. Kontratat e qirasë zakonisht bëhen për periudha fikse nga 3 muaj deri në 5 vjet, por mund të kenë mundësi zgjatjeje. Më poshtë janë vlerat kontabël të aktiveve me të drejtë e përdorimit të njohura dhe lëvizjet gjatë periudhës:

	Ndërtesa
Vlera e mbartur më 1 janar 2020	179,677
Shtesa	167,979
Amortizimi i vitit	(28,169)
Te tjera	(8,374)
Vlera e mbartur më 1 janar 2021	311,113
Shtesa	17,769
Amortizimi i vitit	(29,452)
Të tjera	(17,602)
Vlera e mbartur më 31 dhjetor 2021	281,828

Shoqëria ka njohur detyrimin e qirasë si më poshtë:

	2021	2020
Më 1 janar	318,570	182,172
Shtesa	17,769	167,797
Pakësime dhe modifikime	17,193	26,699
Pagesë qeraje	(62,051)	58,820
Më 31 dhjetor	291,481	318,570

Detyrimi i qirasë afatshkurtër	23,923	57,701
Detyrimi i qirasë afatgjatë	267,558	260,869
Totali i detyrimit të qirasë	291,481	318,570

Shpenzimet e interesit të përfshira në shpenzimet financiare për vitin 2021 ishin 9,016 mijë lekë (2020: 9,811 mijë lekë).

Nuk ka qira që përmbajnë kushte të ndryshueshme pagese që janë të lidhura me shitjet, ose variabël tjetër.

Shpenzimet që lidhen me qira afatshkurtra (të përfshira në shpenzimet administrative dhe qiradhëniet e pasurive me vlerë të ulët që nuk tregohen si qira afatshkurtra (të përfshira në shpenzimet administrative):

	2021	2020
Shpenzime që lidhen me qira afatshkurtra	3,792	4,202
Shpenzimet që lidhen me qiradhëniet e aktiveve me vlerë të ulët, të cilat nuk tregohen më lart si qira afatshkurtra	2,619	2,619

Totali i flukseve të parave për qiradhënie në vitin 2021 ishte 62,050 mijë lekë (2020: 58,820 mijë lekë).

Marrëveshjet e qirasë nuk vendosin asnjë kusht financiar tjetër përveç interesave për pasuritë e dhëna me qira që mbahen nga qiradhënësi. Aktivët e marra me qira nuk mund të përdoren si kolateral për hua.

Opsionet e zgjatjes dhe përfundimit janë të përfshira në një numër të qirave të pronave dhe pajisjeve në të gjithë shoqërinë raportuese. Këto përdoren për të maksimalizuar fleksibilitetin operacional në drejtim të administrimit të pasurive të përdorura në operacionet e Shoqërisë. Shumica e opsioneve të zgjatjes dhe përfundimit të mbajtura janë të ushtrueshme si nga Shoqëria ashtu edhe nga Qiradhënësi përkatës.

15. Aksione në shoqëri të lidhura dhe degë

	2021	2020
VIG Services sh.p.k. (ii)	20,543	20,543
Totali	20,543	20,543

20,543 mijë lekë (2020: 20,543 mijë lekë) përfaqëson investimin e Shoqërisë me 50% (2020: 50% të Shoqërisë në kapitalin e VIG Services Sh.p.k, një shoqëri e themeluar në 2012 si një qendër shërbimesh e përbashkët me qëllim sigurimin e shërbimeve menaxhuese ndaj shoqërive të VIG që operojnë në Shqipëri. Në vitin 2020 Shoqëria ka rritur vlerën e kapitalit në VIG Services sh.p.k me 5,889 mijë lekë.

16. Aktive të risigurimit

	2021	2020
Pjesa e risiguruesit në primin e pafitur	619,678	556,805
Pjesa e risiguruesit në dëmet e raportuara	1,936,172	2,114,932
Totali	2,555,850	2,671,737

Aktivitet e risigurimit të Shoqërisë nuk janë të siguruara dhe as në vonesë apo të provizionuara. Aktivitet monitorohen sipas vlerësimit të kredisë. Për fundvitin 31 dhjetor 2021 dhe 2020 rreziku i kredisë të primeve të çeduar të risigurimit sipas vlerësimit (kërkesë e legjislacionit lokal) është si më poshtë:

	2021				2020			
	Prime të çeduar		Aktive të risigurimit		Prime të çeduar		Aktive të risigurimit	
	'000 Lekë	% e totali	'000 Lekë	% e totali	'000 Lekë	% e totali	'000 Lekë	% e totalit
Vlerësimi								
AA+	17,005	0.01	12,544	0.00	1,504	0.09	-	-
AA	33,730	0.02	120,002	0.05	49,091	3.08	123,288	4.61
AA-	36,736	0.02	22,069	0.01	74,191	4.65	23,201	0.87
A+	1,588,926	0.92	2,317,589	0.91	1,433,633	89.93	2,443,287	91.45
A	29,969	0.02	11,872	0.00	30,203	1.89	15,151	0.57
A-	7,256	0.00	2,438	0.00	1,821	0.11	728	0.03
B++	-	0.00	996		1,759	0.11	-	-
Pa vlerësim	7,867	0.00	68,340	0.03	2,255	0.11	66,082	2.47
Totali	1,721,489	1.00	2,555,850	1.00	1,594,457	100.00	2,671,737	100.00

17. Letra me vlerë me kosto të amortizuar

	2021	2020
Totali në vlerë nominale	3,208,258	2,777,349
Prim i paamortizuar	50,463	36,550
Interes i akumuluar	53,340	43,071
Totali	3,312,062	2,856,970

Në 31 dhjetor 2021 Shoqëria investoi në bono thesari dhe obligacione qeveritare të Shqipërisë dhe Kosovës, me maturitet që mbaron nga 1 vit deri në 10 vjet dhe normë interesi fikse prej 1.85% deri më 8.5 % (2020: maturiteti që mbaron në afat 1 vit deri në 10 vjet dhe normë interesi fikse prej 3.5% deri më 9.25 %). Vlerësimi nga Moodys është B1 për qeverinë shqiptare. Këto janë as në vonesë as të zhvlerësuar në datën e raportimit.

18. Depozita me afat me bankat

Depozitat me afat me bankat më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 përbëhen si më poshtë:

	2021	2020
Depozita bankare	1,555,058	1,600,933
Fondi i garancisë	421,790	405,959
Interes i akumuluar	22,394	29,877
Totali depozita bankare dhe fondi i garancisë	1,999,242	2,036,769

18. Depozita me afat me bankat (vazhdim)

Në përputhje me Nenin 81 të Ligjit për Sigurimet, përsa i përket fondit të garancisë, Shoqëria mban një minimum prej 1/3 të nivelit të kërkuar të marzhit të aftësisë pagueuse por jo më pak se 370 milion lekë, në bono thesari dhe depozita me afat me maturitet prej jo më pak se 1 vit të krijuara si fonde garancie.

Më 31 Dhjetor 2021, fondi i garancisë është 421,790 mijë lekë (2020: 405,959 mijë lekë) i përbërë tërësisht nga depozita me afat në bankat tregtare në Republikën e Shqipërisë. Fondi i garancisë nuk është i disponueshëm për operacionet e përditshme. Të gjitha depozitat me afat nuk janë as në vonesë as të zhvlerësuar.

Kompania ka kërkesa të ngjashme për degën e saj në Kosovë. Në bazë të rregulloreve të Bankës Qëndrore të Kosovës kërkohej një shumë minimale prej 3,200 mijë euro për t'u mbajtur si kolateral (depozita garancie) me BQK dhe banka të tjera komerciale vendore.

Depozitat me afat me bankat përfshijnë depozitat e mëposhtme në lekë dhe monedhë të huaj më 31 dhjetor 2021 dhe 2020:

	2021 Vlera	Interesi në %	2020 Vlera	Interesi në %
Në EUR	1,555,058	0.1-2.91	1,291,258	0.1-2.91
Në USD	421,790	1.2	13,301	1.2
Në Lekë	22,394	1.7-3.2	732,210	0.7-3.2
Totali	1,999,242		2,036,769	

Depozitat bankare, duke përjashtuar fondin e garancisë, janë me maturitete nga 12 muaj deri në 3 vjet.

Mjetet monetare dhe depozitat e Shoqërisë janë vendosur pranë institucioneve financiare si më poshtë:

	2021		2020	
Vlerësimi (ekuivalent i S&P)	Depozita	Llogari rrjedhëse	Depozita	Llogari rrjedhëse
B	506,639	30,947	381,029	16,447
B+	1,197,392	246,270	1,399,140	269,467
B-	286,927	37,338	249,342	16,776
BB-	8,284	851	7,258	2,804
Totali	1,999,242	315,406	2,036,769	305,494

Shoqëria vepron me bankat vendase, të cilat janë kryesisht filiale të grupeve bankare ndërkombëtare. Llogaritë me bankat nuk janë të siguruar. Duke qenë se pak Banka Shqiptare vlerësohen nga agjensitë ndërkombëtare të vlerësimit, Shoqëria përdor vlerësimet e kreditit të aksionerëve më të mëdhenj të bankave për të marrë vendimet e tyre të investimeve si dhe raportet tremujore të Bankës së Shqipërisë mbi bankat që operojnë në treg. Bankat e vlerësuara me CCC+ janë të lidhura me filialet e grupeve bankare greke. Filialet vendore si dhe të gjitha bankat e tjera nuk konsiderohen si me rrezik të lartë bazuar në analizat e likuiditetit të Bankës së Shqipërisë të kryera në baza gjysmë-vjetore. Të gjitha ekuilibrat nuk janë as të vonuara dhe as të zhvlerësuar.

19. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim

Lëvizjet në kostot e shtyra të marrjes në sigurim janë si më poshtë:

	2021	2020
Gjendja më 1 janar	347,761	354,369
Rritje në kostot e shtyra të marrjes në sigurim	837,939	682,949
Kostot e shtyra të marrjes në sigurim të përdorura (Shënimi 34)	(806,168)	(688,300)
Më 31 Dhjetor	379,532	349,018

20. Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera

Të arkëtueshmet bruto dhe neto nga zbritja e të arkëtueshmeve të dyshimta paraqiten si më poshtë:

	2021	2020
Të arkëtueshme nga policëmbajtësit	321,346	286,014
Të arkëtueshme nga shoqëritë e sigurimit	60,636	35,021
Totali	381,982	321,035

20. Llogari te arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe te tjera (vazhdim)

Të arkëtueshmet bruto dhe neto nga zbritja e të arkëtueshmeve të dyshimta paraqiten si më poshtë:

	2021	2020
Të arkëtueshmet nga sigurimet, bruto	381,982	321,035
Minus: Zbritja për humbjet nga zhvlerësimet	(125,468)	(113,579)
Të arkëtueshme nga sigurimet, neto	256,514	207,456

Lëvizjet në zbritjet për humbje nga zhvlerësimet detajohen si më poshtë:

	2021	2020
Gjendja më 1 janar	113,299	107,370
Zhvlerësimi për vitin	7,985	9,030
Fshirje e llogarive të arkëtueshme	4,184	(2,821)
Gjendja më 31 dhjetor	125,468	113,579

Cilësia e kreditit të llogarive të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera paraqitet si më poshtë:

	2021	2020
As me vonesë as të zhvlerësuara	117,814	56,083
Me vonesë por të pa zhvlerësuara	91,403	104,507
Të zhvlerësuara	172,765	160,445
Totali i të arkëtueshmeve bruto	381,982	321,035
Minus: Zbritja nga fondi i zhvlerësimit	(125,468)	(113,579)
Totali	256,514	207,456

Të arkëtueshmet nga policëmbajtësit (bruto) më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 në bazë të statusit të tyre të vonesave janë paraqitur në tabelën vijuese.

	Bruto	Zhvlerësimi	Neto	2021 %
1 deri në 3 muaj	208,049	-	208,049	81.1%
3 muaj deri në 1 vit	59,827	(17,683)	42,144	16.4%
Më shumë se 1 vit	114,106	(107,785)	6,321	2.5%
Totali	381,982	(125,468)	256,514	100%

	Bruto	Zhvlerësimi	Neto	2020 %
1 deri në 3 muaj	160,502	(3,717)	156,785	75.6%
3 muaj deri në 1 vit	58,409	(18,628)	39,782	19.2%
Më shumë se 1 vit	102,124	(91,234)	10,889	5.2%
Totali	321,035	(113,579)	207,456	100%

Të arkëtueshmet nga Shoqëritë e sigurimeve janë grupuar në të njëjtat grupe si sigurimet nga mbajtësit e policave të sigurimit. Rreziku i kredisë menaxhohet gjithashtu duke kompensuar të arkëtueshmet ndaj detyrimeve ndaj siguruesve përkatës pasi këto lindin kryesisht për shkak të kontratave të sigurimit të monedhave. Në vitin 2021, marrëveshje dhe pagesa neto janë kryer me Shoqëri të tjera të sigurimeve dhe ekziston vetëm një bilanc i arkëtueshëm.

21. Aktive të tjera

	2021	2020
Të arkëtueshme nga shoqëri të lidhura	-	505
Paradhënie për punonjësit	1,315	124
Aktive të tjera financiare	1,315	629
Garanci për kartonin jeshil	74,816	75,083
Shpenzime të parapaguara	31,097	11,658
Inventarët	4,477	4,529
Garanci për qira	764	779
Paradhënie për tatimin mbi dividendin	8,036	3,613
Justicia	2,000	2,000
Parapagime ndaj BQK për fondin e kompensimit	22,735	19,927
Aktive të tjera	-	12,896
Totali	145,240	131,114

21. Aktive të tjera (vazhdim)

Paradhëniet e punonjësve nuk janë as me vonesë, as të zhvlerësuar. Këto paradhënie mbahen nga pagat e punonjësve dhe/ose kompensohen me detyrime të tjera kur Shoqëria e shikon të arsyeshme.

Garancia e parapagimit me Byronë e Sigurimeve të Kosovës ka të bëjë me Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar më 23 Qershor 2015, ndërmjet Republikës së Serbisë dhe Republikës së Kosovës në lidhje me njohjen reciproke dhe njohjen e MTPL dhe përpunimin dhe pagimin e kërkesave si rezultat i aksidenteve të shkaktuara nga automjetet në juridiksionin e tyre.

22. Mjete monetare dhe ekuivalente me to dhe mjete monetare të kufizuara

	2021	2020
Para në dorë	6	199
Llogari rrjedhëse	310,899	294,482
Para në bankë në Lekë	112,629	55,420
Para në bankë në valutë	198,270	239,062
Mjete monetare dhe ekuivalentë	310,905	294,681
Llogari të bllokuara	4,501	10,813
Totali	315,406	305,494

23. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë në 31 dhjetor 2021 është 498,213 mijë Lekë (2020: 498,213 mijë lekë) i ndarë në 39,627 aksione me vlerë nominale 12,572.57 lekë. Në 31 dhjetor 2021 dhe 2020 struktura e askionereve është si më poshtë:

	Nr.aksion e	Shuma në '000 Lekë	Në %
Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe	35,289	443,673	89.05%
Z. Evis Prodani	592.67	7,455	1.50%
Z. Jonadri Prodani	592.66	7,444	1.49%
Znj. Lela Prodani	592.67	7,455	1.50%
Z. Qemal Disha	1,480	18,607	3.73%
Z. Rasim Disha	296	3,721	0.75%
Znj. Shefikat Ngjela	488	6,135	1.23%
Z. Idajet Kuka	296	3,723	0.75%
Totali	39,627	498,213	100%

Gjatë vitit shoqëria shpërndau dividendin në vlerën 67,801 mijë lekë (2020: 0 lekë). Vendimi për ndarjen e dividendit gjatë vitit 2021 është marrë më 23 qershor 2020.

24. Rezerva për rreziqe të tjera**Rezervat e rrezikut të sigurimit**

Rezerva e rrezikut të sigurimit është krijuar bazuar në nenin 93 të Ligjit të Sigurimeve. Rezerva është e barabartë me një të tretën e fitimeve të periudhës së mëparshme nëse fitimet nuk përdoren për të mbuluar humbje të akumuluar të trashëguara prej viteve të mëparshme. Kjo rezervë është krijuar për të garantuar aftësinë paguese dhe fondin e garancisë dhe nuk mund të përdoret nga Shoqëria për ndonjë qëllim tjetër. Rezerva nuk është akumuluar më që kur Akti i ri i Sigurimeve hyri në fuqi në 2014. Kompania përjashtohet nga rezerva ligjore sipas kërkesës së Aktit të Kompanive në përputhje me Nenin 9 të Aktit aktual të Sigurimit.

Rezervat ligjore të sigurimeve përfshijnë edhe “Rezervat e kapitalit themeltar” që rrjedhin nga Dega e Kosovës. Rezerva përbëhet nga kapitali themeltar i nevojshëm i cili depozitohet për marrjen dhe mbajtjen e licencës për nënshkrimin e rreziqeve të sigurimit në Kosovë.

24. Rezerva për rrezeqe të tjera (vazhdim)

Edhe pse entiteti Kosovar është degë, kapitali themeltar kërkohet të depozitohet nga zyra qendrore në bazë të Ligjit të Sigurimeve dhe Rregullores “Për llogaritjen e marzheve minimale të aftësisë paguese, mjaftueshmërisë së kapitalit dhe fondit të garancisë për siguruesit e jo-jetës” i datës 23 shkurt 2017. Dega kërkohet të ketë një shumë minimale të kapitalit themeltar prej 3,200 mijë euro të paguar plotësisht në çdo kohë. Këto mjete janë të depozituara në Banka Qendrore e Kosovës dhe bankat e tjera komerciale.

Rezerva e rivlerësimit

Rezerva e rivlerësimit lidhet me matjen e pronave në vlerë të drejtë ku teprica e rivlerësimit njihet në rezervën e rivlerësimit në kapital përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse.

Rezerva e bashkimit

Rezerva e bashkimit në shumën 333,207 mijë lekë përfaqëson aktivet neto të InterAlbanian në 9 Tetor 2014, të cilat janë inkuorporuar në aktivet e Shoqërisë në datën e bashkimit. Rezerva e bashkimit është zvogëluar nga shpërndarja e dividendit në vitin 2018 dhe 2019 në vlerën 104 milionë lekë.

25. Detyrime për kontratat e sigurimit

	2021	2020
Gjendja më 1 janar		
Detyrime bruto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve	3,915,859	3,459,519
Rimarrje nga risigurimet (Shënimi 16)	(2,101,796)	(1,835,796)
Detyrime neto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve në 1 janar	1,814,063	1,623,723
Dëme të ndodhura	1,214,284	1,109,202
Dëme të paguara	(976,175)	(912,661)
Rezerva neto për humbje dhe rregullime të humbjeve në 31 dhjetor	2,052,172	1,820,264
Rimarrje nga risigurimet (Shënimi 16)	1,936,172	2,114,932
Fitim/Humbje nga përkthimi i të pagueshmeve bruto		10,569
Rezerva bruto për humbje dhe rregullime të humbjeve	3,988,344	3,945,765
Ndryshimi bruto në rezervat e sigurimit të dëmeve	(72,287)	(468,666)
Rimarrje nga risigurimet	(165,692)	272,124
Ndryshimi në rezervat e sigurimit, neto	(237,979)	(196,542)

Ndryshimi bruto në detyrimet e sigurimit të dëmeve përbëhet nga ndryshimi bruto i raportuar, por i pashlyer (2021: 2,922,696 mijë lekë dhe 2020: 3,018,965 mijë lekë) dhe rezervat e dëmeve të bëra, por të paraportuara (2021: 1,065,649 mijë lekë dhe 2020: 926,801 mijë lekë).

Rritja e detyrimeve nga kontrata e sigurimit ka ardhur kryesisht nga sa vijon:

Rënia në rezervën e raportuar, por të pashlyer është shkaktuar kryesisht nga shlyerja e dy kërkesave që rrjedhin nga politikat e “pronës të gjitha rreziqet”. Dëmet janë paguar gjatë vitit 2021 duke ndikuar edhe në rritjen e dëmeve të paguara.

Dëmtimet e paguara sipas produktit të sigurimit janë si më poshtë:

	2021	2020
Mjete motorike	1,116,583	1,043,843
Shëndeti	251,240	196,542
Pasuri	487,646	370,186
Dëme të paguara, bruto	1,855,469	1,610,571
Dëme të paguara nga risiguruesi	(879,294)	(697,910)
Dëme të paguara, neto	976,175	912,661

26. Detyrime tatimore dhe të tjera

Detyrimet për taksat dhe të ngjashme, përbëhen si më poshtë:

	2021	2020
Taksa e primit e pagueshme	22,089	21,033
Taksa shtetërore dhe vendore të pagueshme	4,486	6,729
Detyrime për sigurime shoqërore	4,677	4,483
Totali	31,252	32,245

27. Depozita e risiguruesit

Më 31 dhjetor 2021, depozita e risiguruesit ka vlerën 1,276,963 mijë lekë (2020: 1,224,524 mijë lekë). Shoqëria nënshkroi një marrëveshje me VIG AG të tillë që të gjitha aktivet e risigurimit me Vig AG do të paraqitet si një depozitë me një normë të paracaktuar të interesit nga Shoqëria dhe jo si detyrim ndaj risiguruesit. Depozita mund të përdoret nga Shoqëria për të shlyer pretendimet e papaguara ose të ardhshme të bëra që kualifikohen për rimëkëmbjen e risiguruesit.

28. Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera

Detyrimet nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera përbëhen nga:

	2021	2020
Të pagueshme ndaj risiguruesve	153,812	116,624
Të pagueshme ndaj agentëve dhe ndërmjetësve	87,334	81,701
Të tjera të pagueshme	79,058	72,771
Të pagueshme ndaj personelit	20,501	21,974
Të pagueshme ndaj AMF	3,352	3,318
Të pagueshme ndaj shoqërive të sigurimit	17,882	14
Totali	360,938	296,402

29. Primet e shkruara bruto

Primet e shkruara bruto të sigurimit dhe të risigurimit sipas produkteve detajohen si më poshtë:

	2021	2020
Mjete motorike	2,744,729	2,545,529
Pasuri	556,686	511,176
Shëndet	359,143	339,099
Të tjera	112,540	114,683
Totali	3,773,098	3,510,487

Primet e mjeteve motorike detajohen si më poshtë:

	2021	2020
TPL	2,199,303	2,104,600
Kasko	250,421	240,807
Karton Jeshil	162,126	122,858
Polica Kufitare	132,880	77,264
Totali	2,774,729	2,545,529

Primet e shkruara bruto të sigurimit kufitar në shumën 80,443 mijë lekë (2020: 50,748 mijë lekë) kanë të bëjnë me të ardhurat e ndara të Degës së Kosovës nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës ("BSK"). BSK është themeluar sipas Ligjit të Kosovës Nr. 04 / L-018 mbi Sigurimin e Detyrueshëm të Automjeteve Motorike", datë 23 Qershor 2011 dhe administron sistemin për të shitur sigurimin e detyrueshëm të automjeteve motorike me përgjegjësi nga palët e treta ("MTPL") në kufirin e Territorit të Kosovës për drejtuesit e automjeteve të regjistruara të huaja që nuk posedojnë një sigurim të tillë.

30. Rezerva për primet e pafituara

	2021	2020
Gjendja më 1 janar	1,622,070	1,596,105
Prime të shkruara gjatë vitit (shiko shënimin 30)	3,753,074	3,510,487
Minus: Prime të fituara gjatë vitit	(3,642,185)	(3,470,332)
Efekti i përkthimit	-	(811)
Gjendja në 31 dhjetor	1,732,959	1,635,449

	2021	2020
Ndryshimi bruto në rezervën për primin e pafituar	(111,163)	(39,378)
Ndryshimi në pjesën e risiguruesve	63,180	(11,697)
Ndryshimi në rezervën për primin e pafituar, neto	(47,983)	(51,074)

31. Prime të çeduar të risiguruesit

Primet e çeduar të risiguruesit sipas produkteve të sigurimit detajohen si më poshtë:

	2021	2020
Mjete motorike	1,146,506	1,067,098
Pasuri	447,278	403,826
Shëndeti	127,705	123,533
Totali	1,721,489	1,594,457

32. Komisione të risigurimit

Komisienet e risigurimit për 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

	2021	2020
Pasuri	72,654	46,634
Mjete motorike	632,417	584,904
Shëndeti dhe aksidente	158	664
Të tjera	5,272	21,918
Totali	710,501	654,120

33. Të ardhura nga investimet

Të ardhurat nga interesat për 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 në aktive janë si më poshtë:

	2021	2020
Interesat nga obligacionet	127,302	118,882
Interesat nga depozitat me afat	33,060	36,432
Qira dhe të ardhura nga shërbimet	1,470	1,483
Interesat nga llogaritë rrjedhëse	-	1
Totali	161,834	156,798

34. Shpenzime të marrjes në sigurim

	2021	2020
Motorike	616,983	576,610
Pasuri	67,017	64,974
Shëndeti	34,756	34,814
Përgjegjësi	5,654	6,127
Garanci	1,310	1,294
CAR	762	3,124
Kargo	3,188	1,357
Totali	729,670	688,300
Komisioni i sigurimit	633,645	589,537
Shpenzime personeli	88,110	91,554
Shpenzime materiale	7,915	7,208
Totali	729,670	688,300

35. Shpenzime administrative

	2021	2020
Personeli	228,823	211,202
Amortizim	76,405	73,432
Utilitetet dhe qiraja	42,637	44,202
Kontribute në shoqatë dhe BQK	40,219	41,678
Të tjera	32,149	39,721
Reklamë dhe marketing	57,404	38,135
Shpenzime IT	37,501	34,780
Shërbime financiare	16,865	14,163
Konsulencë e jashtme	20,578	12,964
Shpenzime operative të zyrës	8,837	10,827
Zbritje për zhvlerësimin	4,242	9,034
Pajisje zyre	10,994	8,496
Karburant dhe transport	9,740	7,472
Shpenzime komunikimi	6,541	7,352
Shërbime auditimi	4,713	6,190
Mirëmbajtje dhe riparime	4,466	5,365
Mbikqyrje dhe tarifa të tjera	3,927	4,726
Internet	1,217	1,518
Provizione për çështje gjyqësore	-	806
Gjoha	607	508
Udhëtime dhe dieta	765	287
Totali	608,630	572,858

Shpenzimet e tjera përfaqësojnë kostot e telefonit, shpenzimet e përfaqësimit, furnizimet e zyrës dhe donacionet. Shpërblimi i auditorit ligjor për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 ishte 2,792 mijë lekë (2020: 2,732 mijë lekë) dhe lidhet vetëm me auditimin ligjor dhe shërbimet e tjera të lidhura me auditimin, të përfshira në shërbimet ligjore dhe konsulence. Në vitin 2021, numri mesatar i të punësuarve ishte 317 (2020: 305 punonjës). Shpenzimet e personelit ishin:

	2021	2020
Paga	208,473	192,473
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	20,087	18,729
Totali	228,560	211,202

36. Shpenzime të tjera sigurimi

	2021	2020
Kontributi AMF 1.5%	34,328	30,022
Kontributi BSHS	8,554	9,478
Totali	42,883	39,500

37. Fitimi nga kurset e këmbimit, neto

	2021	2020
Fitime nga kursi i këmbimit	271,820	485,416
Humbje nga kursi i këmbimit	(275,358)	(498,150)
Totali	(3,538)	(12,734)

38. Kostot Financiare

	2021	2020
Interesi në depozitë për ri-sigurimin e dhënë	12,870	11,755
Detyrimet e qirasë së shpenzimeve të interesit	8,897	9,441
Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat për vitin	21,767	21,196

39. Tatim fitimi**(a) Përbërësit e shpenzimit të tatim fitimit (të ardhurës)**

Shpenzimi i tatim fitimit i njohur ne pasqyrën e fitim humbjeve përbëhet si më poshtë:

	2021	2020
Tatim fitimi i periudhës	40,587	42,701
Tatim i shtyrë	701	701
Shpenzim tatim fitimi	41,288	43,402

(b) Rakordimi midis shpenzimit të tatimit dhe rezultatit llogaritur me normën e tatimit të aplikuar

Norma e aplikueshme e tatim fitimit për Shoqërinë në Shqipëri në 2021 është 15% (2020: 15%). Operacionet e huaja në Kosovë kanë një normë të aplikueshme tatim fitimi prej 10% (2020: 10%). Një krahasim midis shpenzimit të pritur dhe atij aktual të tatim fitimit është si në tabelën më poshtë:

	2021	2020
Fitim/Humbje para tatimit	272,750	235,754
Tatim fitimi teorik bazuar në normën në (2021: 15%; 2020: 15%)	40,912	35,363
Shpenzime të panjohura	18,206	14,020
Efektet tatimore të zërave të cilët janë të pazbritshëm për efekt tatimor	(17,176)	(5,019)
Efektet e të ardhurave të tatueshme nga transferimi i amortizimit për ndërtesat	701	701
Të ardhura të patatueshme	(1,256)	(1,663)
Shpenzimi i tatim fitimit të periudhës	41,288	43,402

Deklarimet e taksave regjistrohen çdo vit. Sidoqoftë, fitimi ose humbja e deklaruar për qëllime tatimore mbetet e përkohshme derisa autoritetet tatimore të shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrat e tatimpaguesit dhe të lëshohet një vlerësim përfundimtar. Ligjet dhe rregulloret e taksave shqiptare janë subjekt i interpretimit. Periudhat fiskale mbeten të hapura për kontroll nga autoritetet tatimore për pesë vjet kalendarike që paraprijnë vitin kur është dorëzuar deklarata.

c) Analiza e tatimit të shtyrë bazuar në diferencat e përkohshme:

Diferencat midis SNRF-ve dhe rregullave tatimore ligjore në Shqipëri japin diferenca të përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve për qëllime të raportimit financiar dhe bazave të tyre tatimore. Efektet tatimor i lëvizjeve në këto diferenca të përkohshme është detajuar më poshtë

31 dhjetor 2021	Gjendja neto më 1 janar	Njohur në fitim/humbje	Njohur në ATGJ	Gjendja neto më 31 dhjetor	Aktiv tatimor i shtyrë	Pasiv tatimor i shtyrë
Aktive afatgjata materiale	(6,503)	-	701	(5,802)	-	(5,802)
Tatim i shtyrë (detyrim)	(6,503)	-	701	(5,802)	-	(5,802)
31 dhjetor 2020	Gjendja neto më 1 janar	Njohur në fitim/humbje	Njohur në ATGJ	Gjendja neto më 31 dhjetor	Aktiv tatimor i shtyrë	Pasiv tatimor i shtyrë
Aktive afatgjata materiale	(7,907)	-	701	(6,503)	-	(6,503)
Tatim i shtyrë (detyrim)	(7,907)	-	701	(6,503)	-	(6,503)

Detyrimi tatimor i shtyrë i atribuohet ndërtesave në vlerë të drejtë duke sjellë një tepricë pozitive nga rivlerësimi. Detyrimi tatimor i shtyrë llogaritet tek kjo tepricë shtesë që njihet në kapital tek llogaria e rezervës nga rivlerësimi, nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Një detyrim i tillë tatimor i llogaritur sipas normës së tatimit shqiptar prej 15% është njohur drejtpërdrejt në kapital nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

40. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Përgjatë rrjedhës së zakonshme të aktivitetit, Shoqëria është përfshirë në pretendime dhe veprime ligjore të ndryshme. Sipas opinionit të Drejtimit, zgjidhja përfundimtare e këtyre çështjeve nuk do të ketë efekt negativ material në pozicionin financiar të Shoqërisë apo ndryshimin e aktiveve neto. Çështjet ligjore janë të zakonshme kur paditësit nuk bien dakord me vlerësimin e dëmit të bërë nga Shoqëria. Drejtimi i vlerëson pretendimet duke përdorur ekspertizë të jashtme dhe të brendshme përfshirë këtu edhe konsulencën ligjore. Drejtimi beson se keto vlerësime janë të përshtatshme, por sidoqoftë pranon se rezultati final mund të jetë më i lartë ose më i ulët sesa shumat e parashikuara. Më 31 dhjetor 2021 kishte 726 çështje pezull me dëmshpërblime totale të kërkuara nga paditësit prej 1,450 milionë lekësh.

Rastet kanë të bëjnë kryesisht me pretendimet e policave MTPL dhe Karton Jeshil. Dispozitat në lidhje me këto pretendime u bënë bazuar në këshillat ligjore të marra nga Drejtimi dhe pasqyrojnë pritjet për zgjidhjen e këtyre çështjeve. Koha e zgjidhjes është e pasigurt. Në bazë të vlerësimeve të veta dhe të dy këshillave të brendshme profesionale, Drejtimi është i mendimit se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet që tejkalojnë provizionet që janë bërë në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Fondi i kompesimit për MTPL

Shoqëritë e sigurimit të cilat ofrojnë sigurimin e detyrueshëm për mjetet motorike në Shqipëri janë të detyruara të kontribuojnë pranë autoriteteve përkatëse fondin e kompesimit të sigurimit në bazë vjetore në përpjestim të tregut të MTPL-së që ato kanë patur përgjatë vitit të mëparshëm. Shuma dhe koha e pagesave e fondit të kompesimit aprovohet nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare ("AMF") në vijim të propozimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Më 31 dhjetor 2021, Shoqëria ka paguar të gjitha detyrimet e tij për fondin e kompesimit, që rrjedhin nga vendimi i AMF-së.

Ndryshimet e rregulloreve shtetërore për segmentet e biznesit në të cilat Shoqëria operon.

Aktiviteti i sigurimeve është subjekt i mbikqyrjes në Shqipëri. Qëllimi kryesor i këtyre rregulloreve është mbrojtja e policëmbajtësve. Ndryshimet në ligjet dhe rregulloret aktuale të sigurimit mund të ndikojnë mënyrën me të cilën Shoqëria drejton aktivitetin e biznesit dhe produktet që ofron. Për më tepër, përshtatja dhe amendimi herë pas herëshëm i ligjeve të sigurimit ose rregulloreve mund t'i bëjë ato më kufizuese ose të rezultojnë në kosto më të larta sesa kërkesat aktuale. Të tilla ndryshime janë të vështira të parashikohen dhe prandaj vlerësimi më i mirë nga menaxhimi i provizioneve aktuale mund të jetë i materialisht i ndryshëm nga vlerësimet aktuale.

41. Palët e lidhura

Palët përgjithësisht konsiderohen të jenë të lidhura në qoftë se palët janë nën kontroll të përbashkët ose nëse njëra palë ka aftësinë të kontrollojë palën tjetër ose mund të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm ose kontroll të përbashkët mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale. Duke marrë parasysh çdo marrëdhënie të mundshme partiake, vëmendja i drejtohet përmbajtjes së marrëdhënies, jo thjesht formës ligjore.

Komisioni i risigurimit dhe primi që i jepet risigurimit bëhen sipas kushteve kontraktuale që mbizotërojnë në transaksionet në mënyrë të barabartë. Tepricat e papaguara në fund të vitit janë të pasiguruara, pa interes, përveç depozitave të risigurimit (shih shënimin 27) dhe shlyerja e tyre bëhet me para në dorë. Nuk ka pasur asnjë garanci të ofruar apo marrë për ndonjë palë të lidhur të arkëtueshme apo të pagueshme.

Përgjatë vitit Shoqëria ka kryer transaksione me palët e lidhura si vijon:

		2021	2020
Të ardhura	Marrëdhënia		
<i>Të ardhura nga komisionet e risigurimit</i>			
VIG AG	Shoqëria mëmë	630,619	576,289
WIENNER STADTISCHE	Pala kontrolluese përfundimtare	1,028	1,039
VIG RE	Njësi nën kontroll të përbashkët	54,574	49,019
RAY SIGORTA	Njësi nën kontroll të përbashkët	935	221
KOOPERATIVA	Njësi nën kontroll të përbashkët	(11)	-
WIENER RE	Njësi nën kontroll të përbashkët	-	(12)
<i>Të ardhura të tjera</i>			
VIG AG	Shoqëria mëmë	171,204	92,046
VIG RE	Njësi nën kontroll të përbashkët	29,526	18,232
WIENNER STADTISCHE	Pala kontrolluese përfundimtare	-	10,907
Totali		887,875	747,741

41. Palët e lidhura (vazhdim)

Shpenzime	Marrëdhënia	2021	2020
<i>Primi i çeduar në risigurim</i>			
VIG AG	Shoqëria mëmë	1,160,485	1,058,992
WIENNER STADTISCHE	Pala kontrolluese përfundimtare	12,735	13,550
VIG RE	Njësi nën kontroll të përbashkët	248,406	214,888
RAY SIGORTA	Njësi nën kontroll të përbashkët	9,046	721
WIENER RE	Njësi nën kontroll të përbashkët	420	499
<i>Shpenzime të tjera</i>			
VIG AG	Shoqëria mëmë	3,443	2,672
MAKEDONIJA INSURANCE	Njësi nën kontroll të përbashkët	13,201	3,151
VIG Services SH.P.K.	Pjesëmarrje të përbashkëta	42,817	39,280
Kompensimi per menaxhim		41,710	39,097
Totali		1,532,263	1,372,850

Përgjatë vitit Shoqëria ka kryer transaksione me persona të lidhur si vijon:

Të ardhura	Marrëdhënia	2021	2020
<i>Prime të shkruara bruto</i>			
Anëtarë Bordi	Bordi Drejtues	119	91
Aksionerë	Aksionerë	137	107
Anëtar familje të Anëtarëve të Bordit	Person i lidhur	188	31
Totali		444	229

Në çdo datë raportimi, shumat e mëposhtme me palët e lidhura janë përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar:

Aktivët	Marrëdhënia	2021	2020
<i>Pjesa e risiguruesit në rezerva</i>			
Wiener Versicherung Gruppe	Shoqëria mëmë	538,012	899,506
VIG RE	Njësi nën kontroll të përbashkët	688,648	849,207
RAY SIGORTA	Njësi nën kontroll të përbashkët	4,344	62
WIENER RE	Njësi nën kontroll të përbashkët	240	288
WIENNER STADTISCHE	Pala kontrolluese përfundimtare	3,398	2,739
<i>Të arkëtueshme nga sigurimi</i>			
VIG RE	Njësi nën kontroll të përbashkët	5	11
RAY SIGORTA	Njësi nën kontroll të përbashkët	-	-
INTERSIG	Njësi nën kontroll të përbashkët	2	2,205
Totali		1,234,649	1,754,018

Detyrimet		2021	2020
<i>Depozita e risiguruesit</i>			
VIG AG	Shoqëria mëmë	891,838	1,244,524
<i>Risigurime të pagueshme</i>			
VIG AG	Shoqëria mëmë	398,575	400,481
WIENNER STADTISCHE	Pala kontrolluese përfundimtare	4,469	2,783
VIG RE	Njësi nën kontroll të përbashkët	28,133	12,822
RAY SIGORTA	Njësi nën kontroll të përbashkët	5,993	1,090
<i>Detyrime të tjera</i>			
VIG Services SH.P.K.	Pjesëmarrje të përbashkëta	6,206	5,870
Wiener Versicherung Gruppe	Shoqëria mëmë	4,912	5,245
MAKEDONIJA INSURANCE	Njësi nën kontroll të përbashkët	571	-
Totali		1,340,697	1,672,815

42. Ngjarje pas dates së raportimit.

Në shkurt 2022, pas konfliktit ushtarak midis Rusisë dhe Ukrainës, disa vende njoftuan paketa të reja sanksionesh kundër borxhit publik të Federatës Ruse dhe një numri bankash ruse, si dhe sanksione personale kundër një numri individësh.

Për shkak të rritjes së tensioneve gjeopolitike, që nga shkurti i vitit 2022, ka pasur një rritje të ndjeshme të luhatjes në tregjet e letrave me vlerë dhe valutës, luhatje të çmimeve të energjisë dhe benzinës, zhvlerësim të ndjeshëm të rublës ndaj dollarit amerikan dhe euros.

Pritet që këto ngjarje të ndikojnë në aktivitetet e ndërmarrjeve ruse, ukrainase dhe bjelloruse në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Njësia Raportuese nuk ka ekspozime të drejtpërdrejta ndaj palëve të lidhura dhe/ose klientëve kryesorë ose furnitorëve ose bankave nga ato vende. Ndikimi i ngjarjeve të mësipërme mund të ndikojë në kushtet makroekonomike në vend dhe në Evropë, dhe në terma afatgjatë, në vëllimet e tregtimit, flukset monetare dhe rentabilitetin.

Njësia Raportuese i konsideron këto ngjarje si ngjarje jo rregulluese pas periudhës së raportimit, efekti sasior i të cilave nuk mund të vlerësohet në datën e miratimit për publikimin e pasqyrave aktuale financiare me një shkallë të mjaftueshme besimi.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që kërkojnë rregullime ose dhënie informacionesh shpjeguese shtesë për këto pasqyra financiare.